

Strategjia
Në pritje
të përgjigjes
pozitive



**LIGJI I RI PËR
ARSIM**
Fakultete me
profesorë, por që
nuk kanë studentë



Konte
kërkon
votëbesim
nga Çellsi

Antonio



Koha

**Mashtrues dhe
të mashtruar
nga Ballkani**

FORUM

**Tradita
fetare në
Shqipëri dhe
ekstremizmi**



Fatkeqësisht, ngjarjet e negative janë ato të cilat jo vetëm që zënë më shumë hapësirë mediatike, por edhe influencojnë më tepër. Për të qëndruar në këtë temë, një nga ngjarjet më të diskutuara nga vitet 2000 e deri më sot është ekstremizmi. Një fenomen ky i lënë në hijë...

GLOBI

**Gjermanët po
armatosen**

RAJON

**Kanceri në
Kosovë, mbi
1500 raste
për një vit**

KULTURË

**Remzi Nesimi,
ky gardian
i pastërtisë
së shqipes**



SHUMICA SIGURON SE NUK DO TI PËRFILL VËREJTJET E IVANOVIT

ZERO KOMPROMIS PËR GJUHËN SHQIPE



"Shumica parlamentare nuk ka pse ti përfill vërejtjet e presidentit Ivanov. S'do të thotë që ai ka dhënë vërejtje dhe ne duhet ti marrim parasysh, meqë në sistemin tonë juridik është shumica parlamentare që vendosë për miratimin e ligjeve", thonë zyrtarë të lartë partiak në BDI

30 milionë euro dëm nga ndryshimet klimatike

Shkup, 5 shkurt - Ndryshimet klimatike si thatësira dhe dukuritë ekstreme tjera të motit vitet e fundit dëmtojnë mjaft bujqësinë jo vetëm në Maqedoni, por edhe më gjerë. Tendencat e zvogëlimit të reshjeve, breshrit, si dhe të mbulesës së dëborës dhe thatësirës gjatë kohës kur priten reshje, e ngricave të mëdha e kështu me radhë, si problem shqetëson të gjithë bujqit, por edhe ekonominë nacionale për shkak se

shkakton humbje të mëdha për prodhimtarinë bujqësore. Në Maqedoni vetëm vitin e kaluar janë shkaktuar dëme të mëdha në prodhimtarinë e mollës, rrushit, pemëtari të llojeve të ndryshme, orizit... Javë më parë, ministri i Bujqësisë, Ljupço Nikollovski në seancën parlamentare kushtuar pyetjeve të deputetëve theksoi se dëmet e bujqve nga ndryshimet klimatike vitin e kaluar vlerësohen...



EDITORIAL

BILETAT
NJËDREJTIMËSHE

Emin AZEMI

A kemi ne si shoqëri e si institucione një strategji parandaluese që do të frenonte dukurinë e ikjes së të rinjve nëpër vende të ndryshme të Perëndimit? Gjithkush që merr guximin të përgjigjet shpejt e shpejt në këtë pyetje, ka rrezik të ngatërrohet edhe më tepër në labirintet e asaj që krijon entuziazmi dhe pamundësia për ti ndryshuar gjërat. Kjo çështje sa është e vështirë për tu trajtuar me mjete adekuate politike e ekonomike, po aq e koklavitur është edhe për t'u ridimensionuar në planimetrinë e përgjithshme të disponimit tonë social, ekonomik, politik e kulturor. Mungesa e shpresës se këtu vërtetë do të bëhet mirë, nuk lëviz vetëm brenda (pa)mundësive tona për të parandaluar atë që tash më ka marrë udhën e pakthim, por sikur është bërë pjesë e vetë qenies sonë. Nuk ka familje që nuk e ka të paktën një "kandidat potencial" i cili veç më ka filluar kontaktet, të drejtpërdrejta apo të tërthorta, me ndonjë punëdhënës në Gjermani dhe mësimi intensiv i gjuhës gjermane, për shumë shqiptarë të rinj, hë për hë, është bërë preokupim më madhor se çfarëdo qoftë emri do të ketë shteti i tyre që nuk iu ofron perspektivë. Ajo çka krijon habi më të madhe në krejt këtë psikozë largimesh nga vendlindja, është indiferentizmi i faktorëve politik e institucional për të ofruar, të paktën, një plan modest studimi, në të cilin do të ofroheshin disa mundësi dhe gjasa reagimi kundrejt kësaj dukurie. Është e vetëkuptueshme se ky nuk është një problem që mund të zgjidhet brenda natës, por nëse për të nuk flitet hapur dhe nëse nuk jepen disa projeksione variabile për eliminimin e faktorëve që nxisin largimet e të rinjve, atëherë kemi të bëjmë me një mungesë totale të sensit për të prekur realitetin hidhur.

Se çfarë përmasash dramatike ka marrë largimi nga vendlindja, mjafton të shikohen statistikat e regjistrimit të nxënësve nëpër shkollat fillore, ku për çdo vit zbrazen klasë të tëra nëpër fshatra e qytete. Largimi i fëmijëve nga shkollat është një sinjal i keq për të ardhmen e këtij vendi, sepse kjo tani më merr trajtat e shpërnguljes dhe as që bëhet fjalë për ndonjë largim të përkohshëm. Përpos kësaj kategorie sociale, janë jo të paktë edhe ata të rinjtë të cilët ndërpresin studimet në Maqedoni për t'i vijuar të njëjtat në shtete evropiane, me qëllim të qasjes më të lehtë dhe të integritetit më të shpejtë në shoqëritë e shteteve mikpritëse, atje ku edhe aftësohen për profesionet e reja në tregun konkurrues të dijes dhe punës. Kjo po ndodhë zakonisht duke shfrytëzuar edhe mundësinë e lëvizjes së lirë të studentëve brenda hapësirës evropiane, në kuadër të të ashtuquajturit ECTS (Sistemi Evropian i Transferimit të Kredive). Të gjithë këta tregues social e ekonomik nuk do të paraqitnin problem, nëse në ndonjë të ardhme të afërt këtu përpunohet një strategji parandaluese, mirëpo kjo nuk po ndodhë dhe, Maqedonia, jo rastësisht ndodhet në top 10 vendet e Evropës Juglindore me shkallën më të lartë të shpërnguljes së popullsisë. Po ti referohemi të dhënave statistikore që jep Eurostat, do të vërejmë e në 15 vitet e fundit kanë ikur 10 për qind e popullsisë, ose (sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara) nga viti 1990, vendin e kanë lëshuar mbi 20 për qind e banorëve. Nëse para pak vitesh vendi braktisej nga shumëkush që nuk kishte ndonjë profesion të caktuar, tani po ndodhë që bileta njëdrejtimishe të nxjerrin edhe mjekët, informatikanët, arkitektët, ekonomistët, juristët etj. I kja e këtyre të fundit përpos që tregon për simptomat e një gjendjeje, e cila nuk mundet të tejkalohet me indiferentizmin aktual politik e institucional, nxjerr në sipërfaqe edhe konturat e një modeli social-psikologjik të të rinjtë, të cilët vetëm me trup janë këtu, kurse me mendje diku jashtë.

GREQIA NUK MUND TI MBAJË LEKSIONE SHQIPËRISË

"Greqia është i vetmi vend i BE që nuk njeht asnjë minoritet në tokën e saj edhe pse atje jetojnë shtetas grekë më kombësi shqiptare, turke, hebrej, romë, egjiptas, pomak, bullgarë, sllavo-maqedonas, etj. Greqia nuk ka nënshkruar asnjë dokumente ndërkombëtar për zbatimin e të drejtave të njeriut. Pra, një vend si Greqia nuk mund ti mbajë leksione Shqipërisë për zbatimin e të drejtave të njeriut, ku njihen 9 minoritete dhe çdo pakicë kombëtare përfaqësohet denjësisht në çdo poste shtetërore. Në Greqi shtypen edhe të drejtat e besimeve të tjera fetare nga shumica ortodokse e cila është feja zyrtare shtetërore e cila qëndron mbi shtetin. Presidenti i Greqisë Pavlopoulos i përketë krahut ekstremistë nacionalist grek, ai ka mbështetur prej 35 vitesh si politikanë dhe deputet organizatat nacionaliste greke për aneksimin e jugut të Shqipërisë", shkruan historiani Arbe Llalla në profilin e tij në Facebook.

FUNDI I MASHTRIMIT TË MADH

"Fundi i mashtrimit të madh: nuk ka BE për shtetin bizantino jeniçer pa ulur brekët te gjithë! Dhe greket duan gjithçka që ëndërruan. Po ua dhanë grekëve atë që duan, e dinë se përmbysen sepse nuk ka me mundësi të fshehin shitjen e kombit e të shtetit nga ortodokset bizantinë dhe jeniçerët. Po tani?? Tani që nuk kanë rrugë tjetër, maskarenjtë do të bëhen patriotë, shqiptarë etnikë domethënë, dhe kështu kombëtarizmi bëhet strofka e fundit e këtyre horrave. Tani e mbas në Tiranë intensifikohet dhe vazhdon rrëmuja e gjithanshme se nuk dinë se si ta kalojnë këtë dështim të një brezi ndryshe. Po shkon saktësisht si e kam parashikuar.... këto punë shkojnë si shkojnë, me kokë përfundojnë", shkruan prof. Shenasi Rama në profilin e tij në FB.

KUSH ËSHTË LAJM SOT?

"Sot lajm është e keqja jo edhe e mira. Nëse në një vendbanim ndodh një vjedhje prej 100 eurove, kjo bëhet lajm nëpër media. Nëse në një vendbanim ndodh ndonjë vepër e mirë që kushton edhe 1000 euro, ajo nuk bëhet lajm. Është bërë zakon promovimi i të keqes, i cili promovim dita ditës po e shton të keqen. Nuk po bëhet zakon të promovohet e mira që të bëhet motiv për të tjerët apo model. Syri i kamerës drejtohet te gabimet jo te konstruktiviteti në çdo eveniment që ndodh fatkeqësisht", shkruan në profilin e tij në FB, aktivisti humanitar Sead Ramadani.

KARREMI I QUAJTUR REFORMA

"Sa herë që pushtetarët inicojnë reforma apo i referohen tranzicionit, qëllimi kryesor është mbulesa e dështimeve dhe plaçkitja e pasurisë publike e shtetërore për interesa personale, klanore e partiake. Këtu bën pjesë edhe formimi i komisioneve të ndryshme (hetuese) parlamentare, apo 'tack forcat' e ndryshme, të formuara nga qeveria", shkruan në profilin e tij në Facebook, gazetari i njohur nga Kosova, Fahri Musliu.

MEDIACitate

Numri i të vdekurve nga gripi në SHBA që nga tetori i vitit të kaluar, me vdekjen e 16 fëmijëve në një javë të fundit, është rritur në 53. Në njoftimin e publikuar nga CDC, është bërë e ditur se në 7 ditët e fundit në SHBA kanë humbur jetën 16 fëmijë nga gripi. Kështu që nga muaji tetor numri i personave që kanë humbur jetën nga gripi është rritur në 53. Zëvendës drejtorja e CDC, Anne Schuchat, njoftoi se në statistikat për aplikimin e spitaleve nga gripi që nga viti 2010, ky vit është me shifra më të mëdha. Në njoftim theksohet se virusi H3N2 është i përhapur këtë vit dhe se mund të shkaktojë komplikime të ndryshme, ku në disa raste edhe mund të shkaktojë vdekje. Schuchat theksoi se numri i të sëmurëve që shkojnë në spitale për t'u trajtuar është më i madh se atyre të viteve të kaluara. Zyrtarët theksojnë se qeveria amerikane ka marrë masa në shumë fusha në luftën kundër gripit, por çdokush duhet të jetë i kujdesshëm që të mbrojë veten.

(Anadolu Agency, 5 shkurt)

Rreth 3.3 milionë të moshuar kanë nevojë për kujdes shëndetësor në Gjermani, sipas të dhënave provizore të Ministrisë së Shëndetësisë në Gjermani. Numri i tyre rritet, shoqëria plaket shpejt. Deri në vitin 2030 pritet të jenë më shumë se katër milionë. Por për ta mungojnë kujdestarët. Kështu sipas të dhënave të Agjencisë Federale të Punës, për 14.600 vende pune të hapura ka pasur vetëm 3.000 kujdestarë shëndetësorë të papunë. Në të ardhmen do të ketë edhe më shumë mungesa. Fondacioni Gjerman për Mbrojtjen e Pacientit llogarit se në 8 vitet e ardhshme do të mungojnë 200.000 forca pune të plota në sektorin e kujdesit shëndetësor. Deri në vitin 2030 kjo mungesë do rritet deri në 500.000 vetë. Shumë pak të rinj duan të punojnë në këtë profesion. Kushtet e punës janë të vështira, vlerësimi për këtë lloj pune i vogël. "Shumë kujdestarë i kthejnë kurrizin kësaj pune, sepse kuptojnë se kanë aty kufijtë e tyre fizikë dhe shpirtërorë", thotë Eugen Brysch nga Fondacioni për Pacientët. Rol luan edhe pagesa jo e mirë.

(DW, 5 shkurt)

NËSE S'E
DINI...

DERI NË SA VITE MUND TË JETOJË ARRAT?

Arra jeton gjatë 200 deri në 300 vjet. Ajo nis e jep kokrra 10 deri në 15 vjet pas mbjelljes. Emri i saj shkencor është "Juglans Regia". Arrin lartësi deri në 20 metra dhe trashësi deri në 3 metra. Arra gjendet kudo në Shqipëri,

por më me famë janë arrat e Gizavezhdit në Librazhd, të Smokthinës në Vlorë, arrat e Dibrës etj. Për shkak të jetëgjatësisë dhe bukurisë, druri i arrës është nga më të çmueshmit për orenditë shtëpiake.



"Shumica parlamentare nuk ka pse ti përfill vërejtjet e presidentit Ivanov. S'do të thotë që ai ka dhënë vërejtje dhe ne duhet ti marrim parasysh, meqë në sistemin tonë juridik është shumica parlamentare që vendosë për miratimin e ligjeve", thonë zyrtarë të lartë partiak në BDI

SHUMICA SIGURON SE NUK DOTI PËRFILL VËREJTJET E IVANOVIT ZERO KOMPROMIS ME VMRO PËR GJUHËN SHQIPE



Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 5 shkurt - Miratimi i Ligjit për gjuhë shqipe nuk do të pres kompromis politik mes pushtetit dhe opozitës, por do të futet në rend dite për votim në momentin e duhur gjatë seancës plenare. Sipas zyrtarëve të lartë partiak nga BDI, shumica parlamentare nuk do ti përfillë vërejtjet e presidentit Gjorgje Ivanov duke i konsideruar ato si jo kompaktibile me rregullat kushtetues në fuqi. Sipas këtyre zyrtarëve, Ligji për gjuhët do të votohet shumë shpejtë në seancë plenare pa mos e precizuar ditën se kur. "Shumica parlamentare nuk ka pse ti përfillë vërejtjet e presidentit Ivanov. S'do të thotë që ai ka dhënë vërejtje dhe ne duhet ti marrim parasysh meqë në sistemin tonë juridik - është shumica parlamentare që vendosë për miratimin e ligjeve. Ne, për shembull, mund të konsiderojmë se ato vërejtje nuk janë kompaktibile me dispozitat kushtetuese, në të cilat mbështetet Ligji për gjuhët dhe në këtë kontekst mund ti hedhim poshtë të gjitha amendamentet e VMRO-së", thonë zyrtarë të lartë partiak të BDI-së. Të njëjtit përjashtuan çdo kompromis me VMRO-në ngaqë, sipas zyrtarëve të partisë së Ali Ahmetit, lidhur me gjuhën shqipe nuk bëhen pazare politike për asnjë çmim. "Si shumicë parlamentare nuk kemi pse të bëjmë kompromis me VMRO-në. Për gjuhën shqipe zyrtare nuk do të bëhen pazare politike. Askush nuk do të vë çmim për gjuhë shqipe. Thjeshtë, shumica edhe njëherë do të votojë siç votoi në lexim të dytë për Ligjin për gjuhët,

me çka do të verifikohet ajo që bëjmë më herët", thonë zyrtarë të lartë të BDI-së. Nga ana tjetër, deputetë të LSDM-së po ashtu kanë përjashtuar çfarëdo ndryshimi të Ligjit për gjuhët. Njëri nga funksionarët më të lartë të saj tha për gazetën KOHA se "Ligji për gjuhët nuk do të preket në asnjë nen, por do të votohet ashtu siç u votua më herët". Ndryshe, të hënën ka mbaruar përkthimi i 35 mijë amendamenteve të parashtruara nga VMRO në funksion të vërejtjeve të presidentit Ivanov, ndërsa mbi 99 për qind e tyre kanë të bëjnë me dënimet ndaj institucioneve që nuk do ta zbatojnë ligjin për gjuhët. Po të hënën, kryeparlamentari Talat Xhaferi ka pasur takim joformal me koordinatoret e Grupeve parlamentare. Sipas mediave maqedonase, Xhaferi u ka thënë atyre që nuk do të thërras seancë pa gjetur gjuhën e përbashkët për Ligjin për gjuhët. Po sipas mediave maqedonase, është pritur që kryeministri Zoran Zaev mbrëmjen e së hënës të takohet me bashkëpartiakët e vet rreth ndodhive në Parlament dhe zgjidhjeve të mundshme. Sipas

burimeve që kanë referuar mediat, teknikisht janë siguruar kushtet për fillimin e seancës ku duhet të fillojë debati për amendamentet, por me gjasë çështja duhet të zgjidhet politikisht.

Zyrtarisht nga shtëpia ligjvënese thonë se gjatë periudhës në vijim është e pamundur të fillohet seancë e re, pasi një numër i madh i deputetëve do të jenë jashtë shtetit si pjesë e delegacionit parlamentar. Prej atje thonë se përkthimi i amendamenteve në gjuhën shqipe ka përfunduar, por ekzistojnë procedura teknike që duhet të përpunohen. "Pjesa e përkthimit tashmë është gati, ndërsa Parlamenti po punon për përfundimin edhe të procedurave të tjera, që diskutimi për këtë Ligj të fillojë sa më shpejtë në lexim të tretë në seancë plenare", thonë nga kabineti i kryetarit të Parlamentit, Talat Xhaferi. Sa i përket zhvillimeve tjera në Parlament, LSDM dhe VMRO ende po mbajnë fshehur Grupin punues i formuar enkas për të punuar rreth kthimit të partisë më të madhe opozitare në Parlament. Sipas disa informacioneve jozyrtare, nga VMRO anëtarë të këtij grupi

pi janë ish-kryeministri teknik Emil Dimitriev, Vlatko Gjorçev, ish-kryeparlamentari Trajko Veljanovski dhe ish-ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Popovski. Ndërsa nga LSDM përmenden emrat e koordinatort të Grupit parlamentar Tomislav Tuntev dhe deputetes Frosina Ramenski. Por as nga njëra as nga tjetra parti nuk kanë pranuar të flasin se deri ku kanë arritur bisedimet dhe nëse presin rezultat pozitiv që VMRO të kthehet në Parlament. Ndryshe VMRO po bojkotin seancat plenare dhe seancat e komisioneve parlamentare, por që nuk ka bojkotuar tërësisht Parlamentin. Deputetë të saj kanë brifuar shpesh për gazetarët dhe kanë pasur konferenca për shtyp në Parlament, ndërsa nuk lanë lëshuar as kabinetet e tyre personale. Deputetë të VMRO u kthyen vetëm në seancën 32 kur ishte në rend dite pika për gjuhën shqipe, ndërsa u zotuan se edhe më tej nuk do ti kthehen punës në Parlament përdërisa ka ende deputetë të saj të burgosur, sipas tyre, padrejtësisht në lidhje me ngjarjet e dhunshme të 17 prillit të vitit të kaluar.

Emri dhe çështjet e identitetit ndikojnë në perceptimin për BE-në

Shkup, 5 shkurt - Emri dhe çështjet e identitetit fuqishëm ndikojnë në perceptimin e qytetarëve për anëtarësimin në BE, tregon anketa debatuese për përfitimet dhe sfidat nga anëtarësimi i Maqedonisë në BE e zbatuar nga Instituti për Politikë Evropiane. Anketa është zbatuar prej datës 1 deri më 7 nëntor të vitit 2017, kur janë anketuar 1200 persona, si dhe më datën 18 dhe 19 nëntor kur janë anketuar 150 pas një ngjarjeje debatuese të organizuar për anëtarësimin në BE, emrin dhe identitetin. Para debatit, 30 për qind e kundërshtuan plotësisht integrimin në BE për shkak drujtjes nga ndryshimi i identitetit kombëtar ndërsa pas debatit kjo shifër u ulët në 19.6 për qind. Rezultatet nga anketa tregojnë se para debatit, 28 për qind nga të anketuarit fuqishëm e mbështesin ndryshimin e emrit kushtetues nëse emri Maqedoni dhe gjuha maqedonase janë të garantuara, ndërsa pas debatit mbështetja është rritur në 40.9 për qind. Qëndrimi kundër ndryshimit të emrit kushtetues për anëtarësimin në BE mbetet, shënon ndryshim të vogël, kështu që përpara debatit kundër ndryshimit të emrit kushtetues janë 31.4 për qind, ndërsa pas debatit 32.9 për qind. Aleksandar Jovanovski nga IPE, në prezantimin e së hënës të rezultateve, tha se anketa debatuese i tregon preferencat dhe mendimet e qytetarëve para dhe pas njohjes më të hollësishme me temën. Pas anketës debatuese, 63.7 për qind e të anketuarve plotësisht e mbështesin anëtarësimin në BE, kundrejt 52.2 për qind përpara debatit. Është interesante që pas debatit, 5.3 për qind e të anketuarve kanë thënë se Maqedonia plotësisht i përmbush kriteret demokratike për t'u inkuadruar në BE, kundrejt 11.5 për qind përpara debatit.

Marrëveshja me Bullgarinë, kyçen edhe akademitë

Sofje, 5 shkurt - Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë (ASHAM) dhe Akademia e Shkencave të Bullgarisë (ASHB) në takimin e sotëm në Shkup kanë shprehur gatishmëri t'u ndihmojnë Qeverive të tyre në realizimin e Marrëveshjes për miqësi dhe bashkëpunim dhe për atë qëllim të dy akademitë do të formojnë grup ndërakademik, të udhëhequr nga kryetarët e tyre. Ky grup ndërakademik, ashtu siç qëndron në kum-

tesën e ASHAM, duhet të kontribuojë për konkretizimin e formave dhe përmbajtjet për bashkëpunim të parashikuara në Marrëveshje. Takimi është mbajtur në suaza të bashkëpunimit të rregullt mes ASHAM dhe ASHB, ndërsa delegacionin bullgar e ka udhëhequr kryetari, akademiku Julijan Revalski. Në takim, ashtu siç kumtoi ASHAM, është potencuar vlera e Marrëveshjes për miqësi dhe bashkëpunim mes Republikës së Maqedonisë

dhe Republikës së Bullgarisë si nxitje e fuqishme për thellim të mëturshëm të bashkëpunimit mes të dy vendeve dhe akademive në shkencë, dituri, kulturë, ekonomi, afrimi i njerëzve të rinj dhe rajone të tjera në krijimin e pranimit dhe zbatimit të vlerave të përbashkëta evropiane. "Përvojat e bashkëpunimit të deritanishëm mes të dy akademive, e cila parapritur e dha kontributin e saj në arritjen e Marrëveshjes për miqësi dhe ba-

shkëpunim, e themelojnë bindjen se vetëm me qasjen e tillë, specifike për shkencën, kulturën dhe artin hapen perspektiva të reja për Ballkanin si rajon i paqes, stabilitetit dhe zhvillimit", citohet në kumtesë. Për atë qëllim, të gatshëm t'u ndihmojnë Qeverive të tyre në realizimin e Marrëveshjes, të dy akademitë do të formojnë grup ndërakademik, të udhëhequr nga kryetarët e tyre, i cili duhet të kontribuojë për konkretizimin e

formave dhe përmbajtjeve për bashkëpunim të parashikuar në Marrëveshje. Në takim janë saktësuar projektet artistike të përbashkëta shkencore-hulumtuese në të cilat do të punohet në tre vitet e ardhshme, janë dakorduar aplikime për projekte hulumtuese-shkencore të financuara nga fondet dhe projektet strukturore evropiane që do të realizohen në kornizat e bashkëpunimit trilateral ASHAM-ASHB-ASHAS.

"TO VIMA" PËR ZGJIDHJETË KONTESTIT ME EMRIN

KJO ËSHTË "PAKOJA E IDEVE" TË NIMICIT

Pesë propozimet e dorëzuara negociuesve më 17 janar janë "Republika Maqedonia e Epërme", "Republika Maqedonia Veriore", "Republika Maqedonia e Vardarit", "Republika Maqedonia e Re" dhe "Republika Maqedonia (Shkupi)", por përmend edhe se Nimic është i hapur edhe për propozime të tjera



Athinë, 5 shkurt - Emri i ri tërësisht të miratohet edhe për përdorim të brendshëm edhe për të jashtëm, por pas integritimit në BE; nuk ekziston ndryshim i detyrueshëm i kushtetutës; Nimic e përsëritë klauzolën e joekskluzivitetit për termet "maqedonase" dhe "Maqedoni" për përdorim ekonomik; emri i ri të përdoret i papërkthyer apo i përkthyer sipas zgjedhjes së secilës palë; këto janë disa nga pikat e "pakos së ideve" të ndërmjetësit të KB-së, Methju Nimic, që e publikoi të hënën gazeta "To vima". Sipas "To vima", në pakon që Nimic më 17 janar ua

dorëzoi dy ndërmjetësve, nuk është përmendur ndryshimi i obligueshëm i Kushtetutës së IRJM-së që të ndërrohet emri i sotëm kushtetues apo pikave të tjera që sipas disave kanë përmbajtje irredentiste. "Qeveria e IRJM-së është kompetente të vlerësojë se cilat do të jenë "procedurat obliguese, të besueshme dhe të përvokueshme nacionale" për zbatimin e zgjidhjes. Nimic propozon që dy vendet sërish të konfirmojnë se nuk kultivojnë pretendime territoriale apo kërkesa (ky propozim është në bazë të reciprocitetit), si dhe për respektim të ndërsjellë

të trashëgimisë kulturore", shkruan "To vima". Sipas "pakos së ideve" së Nimicit, siç transmeton gazeta, miratimi i emrit të ri dhe përfundimtar që do të jetë erga omnes, është i lidhur drejtpërdrejt dhe vetëm me integrimin në Bashkimin Evropian. Që do të thotë se emri kushtetues do të vazhdojë të jetë në fuqi deri në hyrjen në Union. Këtë të njëjtën, javën e kaluar e publikoi edhe gazeta greke "Katimerini". "Lidhur me ftesën për integrim të IRJM-së në NATO, Nimic thekson se deri në datën në të cilën Shkupi zyrtarisht do të bëhet anëtare e Aleancës

veri-atlantike do të duhej të ndërmerren të gjitha masat e domosdoshme në mënyrë që të rregullohen marrëdhëniet bilaterale me vendet e tjera anëtare në bazë të emrit të ri zyrtar që sipas rendit alfabetik do të regjistrohet nën shkronjën M", shkruan "To vima". Gazeta, duke iu referuar dokumentit të ndërmjetësit, i konfirmoi informatat e publikuara në medime për pesë propozimet e dorëzuara negociuesve më 17 janar: "Republika Maqedonia e Epërme", "Republika Maqedonia Veriore", "Republika Maqedonia e Vardarit", "Republika Maqedonia e Re" dhe "Republika Maqedonia (Shkupi)", por përmend edhe se Nimic është i hapur edhe për propozime të tjera. "To vima", publikon se ndërmjetësi në tekstin e ri si shembull në mënyrë që t'i prezantojë idetë e reja e përdorë emrin "Republika Maqedonia E Epërme", diçka që kohë më parë shkaktoi spekulime në medime se për këtë emër janë dakorduar të dyja palët. "Në çështjet për nacionalitetin dhe gjuhën (çka prezantojnë dy shtyllat e identitetit dhe shkaktuan tensione gjatë vizitës së kohëmëparshme të zotëri Nimicit në Shkup dhe për atë që e tha ministri i Shkupit i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov), përfaqësuesi i posaçëm propozon ob-

sionin: versioni slloven "makekdonski" apo përkthimi në bazë të emrit zyrtar apo në bazë të versionin të shkurtë të emrit (p.sh. Qytetar i Republikës Maqedonia e Epërme), publikon gazeta greke. Lidhur me përdorimin ekonomik, Nimic, sipas "To vima"-s, e përmend "klauzolën e joeksluzivitetit" gjatë përdorimit të shprehjeve "Maqedoni" dhe "maqedonas" dhe u bën thirrje të dyja palëve të vijnë deri te marrëveshja e ndërsjellë që do të mund të zbatohet në të gjitha gjuhët për përdorim të këtyre termeve. "Së pari, se vetë termin Maqedoni në formë të papërkthyer apo të përkthyer, Shkupi nuk do ta përdorë si emër zyrtar të shtetit në asnjë kornizë. Së dyti, se termet "ish-republika jugosllave Republika e Maqedonisë" dhe IRJM do të ndalojnë së përdoruri në kontekst të Shkupit. Së treti - dhe siç duket më me rëndësi - termi Republika e Maqedonisë (Republika Makedonija) do të vazhdojë të përdoret për përdorim të brendshëm deri në datën e anëtarësimit në BE", shkruan gazeta. "To vima" lajmëron korrespondenti i MIA-s nga Athina, i analizon edhe parakushtet dhe komplikimet e mundshme që do të dilnin, por edhe pjesët për të cilat nevojiten sqarime nga ndërmjetësi.

SOT PUBLIKOHET STRATEGJIA E KE-SË PË BALLKANIN PERËNDIMOR

Në pritje të përgjigjes pozitive

"Nëse marrim datë, kjo do të jetë nxitje që ne t'i arrijmë edhe shtetet e tjera të cilat e kryesojnë vetë procesin", thotë zëvendëskryeministri Bujar Osmani

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 5 shkurt - Maqedonia pret në Strategjinë për zgjerim të cilën Komisioni evropian do ta publikojë sot (e martë), të marrë perspektivë të qartë evropiane, por edhe mundësi për ta arritur afatin që së bashku me Serbinë dhe Malin e Zi në vitin 2025 të bëhet pjesë e Unionit, deklaroi zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane, Bujar Osmani. "Presim që Maqedonisë të marrë sinjal të qartë se ka perspektivë, kuptohet pas mbylljes së çështjeve të hapura politike në kuptimin e marrëdhënive me fqinjët, të marrë datë për negociata, por gjithashtu është me rëndësi të fitojë mundësi ta arrijë afatin së bashku me Serbinë dhe Malin e

Zi, kuptohet nëse ndërkohë arrijmë t'i përmbushim kriteret. Me rëndësi është të na jepet mundësi, e më pas gjithçka do të varet prej nesh", tha zëvendëskryeministri Osmani para mbajtjes së mëngjesit të punës me ambasadorët e vendeve nga Ballkani Perëndimor në Republikën e Maqedonisë.

Sipas tij, duhet të kihet parasysh se Maqedonia ka përvojë më të madhe në këtë proces, më së gjatë është në këtë proces dhe në realitet ka arritur shumë në kuptimin e harmonizimit me legjislatoren evropiane dhe në përmbushjen e kriterëve. "Nëse marrim datë, kjo do të jetë nxitje që ne t'i arrijmë edhe shtetet e tjera të cilat

e kryesojnë vetë procesin", thotë Osmani. Ai deklaroi se zyrtarisht dokumenti që sot do të prezantohet në Strasburg, autoriteteve të Maqedonisë do t'u dorëzohet nga euroambasadori Samuel Zhbogar. Lidhur me përmbajtjen e dokumentit, Osmani theksoi se kanë njohuri preliminare për atë se çka përmban ai duke pasur parasysh se në këtë periudhë janë zhvilluar komunikime intensive me Brukselin, por edhe me vendet anëtare të BE-së, si dhe me vendet e rajonit.

"Për ne është me rëndësi t'i fillojmë negociatat. Maqedonia ka arritur mjaft në atë proces dhe deri më tani në këto 17 vite prej se është nënshkruar Marrëveshja për sta-



bilizim dhe Asociim punojmë në harmonizimin e legjislaturës dhe konsiderojmë se nëse fillojmë negociata, shumë shpejtë do të hapim dhe mbyllim kapituj, sepse ne edhe para se të fillojë negociata kemi punuar në atë proces dhe kemi arritur rezultate. Prandaj për ne është me rëndësi të na jepet

mundësia që edhe ne ta arrijmë afatin, vitin 2025, sepse konsiderojmë se do ta kompensojmë shpejtë mangësinë në proces gjatë periudhës së kaluar", theksoi Osmani. Zëvendëskryeministri Osmani sot ka mëngjes pune me ambasadorët e vendeve nga Ballkani Perëndimor në Republikën e Maqedonisë. Ky është takimi i dytë koordinues i formatit të këtyre për shkak të rëndësisë së momentit të eurointegritimit dhe koordinimit dhe sinkronizimit të qëndrimeve, ndërkaq në prag të publikimit të nesërm të Strategjisë për zgjerim të BE-së. Sipas Osmanit, është me rëndësi që me Strategjinë ndërron qasja, përkatësisht jepet kornizë kohore për zgjerim të Evropës me vendet nga Ballkani Perëndimor.

PROTESTAT DEMOKRATIKE, POR NUK DUHET TË NDIKOJNË NË NEGOCIATA

Zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, duke i komentuar protestat që u mbajtën dje në Athinë, vlerësoi se janë pjesë e debatit politik publik i cili zhvillohet në formë të ndryshme dhe është e drejtë demokratike e garantuar nëse janë paqësore dhe jo të dhunshme, dhe se kjo nuk duhet të ndikojë në procesin për zgjidhjen e çështjes së emrit. "Megjithatë, gjithashtu, nuk duhet të nënvlerësohet edhe numri i madh i njerëzve që mbështesin gjetjen e zgjidhjeve dhe janë kundër kësaj mënyrë të shprehjes së pakënaqësisë.

Asnjëherë nuk kemi menduar se kjo është çështje është e lehtë dhe se do të zgjidhet pa ndonjë sfidë në rrugë. Ajo që është e rëndësishme është se kemi qeveri që janë të vendosura për të gjetur një zgjidhje. Ato duhet të mbeten të qeta dhe konsistente në gjetjen e zgjidhjes, pavarësisht sfidave me të cilat do të përballlemi gjatë rrugës. Tani është koha e sjelljes së vendimeve të drejta, e jo të lehta", tha Osmani para mëngjesit të punës me ambasadorët e vendeve nga Ballkani Perëndimor, ndërsa në pritje të publikimit të Strategjisë së BE-së për zgjerim.

MUNGESA E GORAN GRUJEVSKIT ANULON SEANCËN GJYQËSORE

"TREZORI" ÇAKTOHET PËR 29 MARS

Në bazë arsyetimit të avokatit Vasilev, gjykatësja Xheneta Bektoviq e prolongoi seancën për datë 29 mars, dy ditë më vonë se kur pritet të mbahet seancë për rastin "Target-Fortesa", në të cilën po ashtu si i akuzuar ngarkohen Goran Grujevski

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 5 shkurt - Mungesa e ish-shefit të Drejtorisë së Pestë, Goran Grujevskit, ishte shkaku kryesor se pse lënda për rastin "Trezor" të hënën u prolongua nga Gjykata Penale e Shkupit. Përveç këtij të akuzuari, i dyshuar për keqpërdorim të mjeteve për furnizim me pajisje për spiunim, për të njëjtën vepër ngarkohet edhe ish shefi i policisë sekrete, Sasho Mijallkov, ish shefi i kabinetit të tij, Toni Jakimovski dhe ish ndihmës Ministri i Punëve të Brendshme, Stajkoviq. Avokati Petar Vasilev, njëherësh këshilltar juridik i ekipit të avokatëve që e përfaqësojnë Goran Grujevskin, para gjykatës në Shkup tha se për momentin - procedura e ekstradimit të Grujevskit, gjendet në fazën e ankimit para Gjykatës së Lartë të Greqisë. Duke ju përgjigjur në pyetjet e Trupit gjyqësor, të udhëhequr nga gjykatësja, Xheneta Bektoviq, avokati Vasilev sqaroi se gjykata e shkallës së parë e ka miratuar kërkesën e GJPSH-së për ekstradim të Grujevskit, mirëpo ndaj të njëjtës është parashtrua ankesë para gjykatës së shkallës së dytë. "Sinqerisht nuk mund të kalkulojë me datë dhe afate se kur pritet që Gjykata e Lartë e Greqisë, të prononcohet, gjegjësisht të vërtetohet apo jo vendimin e shkallës së parë, për ekstradimin e Grujevskit në



Maqedoni. Praktika gjyqësore thotë se një vendim i tillë mund të miratohet prej tre deri në gjashtë muaj, tha avokati Vasilev. Në bazë fjalimit të Vasilevit dhe në mungesë të kushteve ligjore për fillim të procesit gjyqësor për rastin "Trezor", gjykatësja Bektoviq, e prolongoi seancën për datë 29 mars, dy ditë më vonë se kur pritet të mbahet seanca për rastin "Target-Fortesa", në të cilën po ashtu si i akuzuar ngarkohen Goran Grujevski. Aktakuza e iniciuar nga Prokuroria Speciale Publike, ish-përbërjen e ngushtë të policisë sekrete e ngarkon për keqpërdorim të mjeteve financiare për furnizim me një softuer nga jashtë, për nevojat e Drejtorisë së Pestë. Sipas kësaj aktakuze - Mijallkovi, Jakimovski dhe Grujevski, në vitin 2010, kanë udhëtuar për në Londër, me çka kanë nënshkruar marrëveshje për blerjen e mjeteve për përcjelljen e komunikimeve dhe trajnimin se si duhet të shfrytëzohen ato pajisje. Megjithatë, pika kontestuese të cilën e heton PSP, ka të bëjë me faktin se ky furnizim ndonëse është dashur të realizohet përmes MPB-së, ato kanë shkuar përmes kompanisë "Finzi", si përfaqësues

se e ministrisë. Tutje, në aktakuzë qëndron se pasi "Finzi" e ka marrë përsipër blerjen e këtyre pajisjeve në emër të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe MPB-së, importin e pajisjeve në fjalë i ka faturuar për një çmim të dyfishtë. Element tjetër kontestues është koha e furnizimit, që është realizuar në vitin 2010, ndërkohë kompania "Finzi" ka qenë e formuar gjatë viti 2009. Gjatë kësaj periudhe ajo nuk ka pasur asnjë person të punësuar, aq më pak edhe mjete për të blerë këto pajisje, të cilët llogariten se kanë kaluar shifrën e 35 milionë denarëve. Ndryshe, kjo kompani ka qenë e regjistruar në SHBA, dhe si drejtor i parë i asaj është regjistruar Vlladislav Stajkoviq, vëllai i të akuzuarit Nebojsa Stajkoviq. Ndërkohë drejtori i fundit i kompanisë "Finzi" ka qenë Kosta Kërpaç, dëshmitari PSP-së, i cili në rrethana të dyshimta bëri vetëvrasje. Sidoqoftë, në njërin prej prononcimeve të rralla të tij, ish shefi i policisë sekrete, Sasho Mijallkov, lidhur me këto akuza, pati deklaruar se në asnjë çast gjatë kohës sa ka qenë drejtor i DSK-së, nuk e ka dëmtuar buxhetin e shtetit, aq më pak të ketë fituar ndonjë të mirë materiale.

KRONIKË

Rrahje në një lokal, arrestohen katër persona

Të dielën mbrëma në mesnatë është denoncuar prishja e rendit dhe qetësisë publike ku në rrahje janë përfshirë disa persona. Rrahja ka ndodhur në një objekt hotelierik në rrugën 133 në Tetovë. Pas arritjes së pjesëtarëve të Policisë në vendngjarje, është vërejtur dhe më pas arrestuar 22 vjeçari M.Gj nga Tetova, i cili me shufër metalike ka thyer dyert e objektit. Më pas, poashtu një i ri tjetër 20 vjeçar F.D nga Tetova që ka qenë në afërsi ka tentuar të ik, por është kapur. Sipas policisë, krahas tyre janë arrestuar dhe mbajtur E.Z 33 vjeçar nga Tetova dhe A.R nga Ohri për shkak të dyshimeve për involvimin e tyre në prishjen e rendit. Pas kryerjes së bisedës informative, katër personat janë lëshuar dhe pas zbardhjes së plotë të rastit do të përballesh me padi penale.

Zbulohen 5 emigrantë ilegal në Reçicë

Policia të dielën i ka zbuluar pesë emigrantë prej të cilëve tre kurdë dhe dy sirianë në një automjet të drejtuar nga një qytetar i Shkupit në afërsi të fshatit Reçicë. Drejtuesit të automjetit i është caktuar paraburgim prej tridhjetë ditësh. Në kumtesën e MPB-së, thuhet se në afërsi të fshatit Reçicë, nëpunësit policorë të Stacionit Policor Bellanocë gjatë kontrollit të automjetit motorik me targa të Shkupit, i drejtuar nga I.B. (36) nga Shkupi, i kanë gjetur tre kurdë A.M. (26), S.K. (35) dhe D.F. (26) dhe dy sirianë A.A.A. (27) dhe M.K.A. (18). Ata së bashku me shoferin janë dërguar në Stacionin policor. Nga Gjykatësi i Gjykatës Themelore - Shkup, I.B. i është përcaktuar paraburgim në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Lëndohet me thikë një grua gjatë tentimit për grabitje

Një grua 26-vjeçare mbrëmë në shtëpinë e saj në Kisella Vodë, u lëndua gjatë tentimit për grabitje nga ana e dy personave të panjohur. Siç kumtoi MPB-ja, incidenti u denoncua rreth orës 22:30, ndërsa ka ndodhur në rrugën "Arkitekt Nikolla Dobroviq", kur dy persona të panjohur kanë hyrë në shtëpinë e Zh.T. (26) dhe kanë filluar t'i kërcënohen, duke i kërkuar para. "Personat pastaj e kanë shtyrë në dysheme dhe me thikë i kanë shkaktuar plagë në këmbën e djathtë dhe dorën e majtë, pas çka e kanë braktisur vendin e ngjarjes. E lënduara Zh.T me automjet të ndihmës urgjente mjekësore u dërgua në Kompleksin e Klinikave "Nënë Tereza" për dhënien e ndihmës mjekësore", njoftojnë nga MPB-ja. Ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekip i SPB-së-Shkup. Punohet në ndriçimin e tërësisht të rastit.

Shkup, 22 aksidente me një të vdekur

Një motoçiklist e humbi jetën, një çiklist është lënduar rëndë, ndërsa 16 persona kanë marrë lëndime të lehta trupore në 12 nga gjithsej 22 fatkeqësi komunikacioni të evidentuara fundjavën e shkuar në rajonin e SPB Shkup. Policia rrugore regjistroi dhe sanksionoi 105 vozitës për tejkalim të shpejtësisë së lejuar. Nga komunikacioni janë përjashtuar 41 vozitës, katër për vozitje nën ndikim të alkoolit, 33 para se të fitojnë të drejtën e vozitjes, si dhe katër fillestarë. Nga 27 automjete të përjashtuara nga komunikacioni, dy kanë qenë teknikisht në gjendje jo të rregullt, ndërsa 25 të paregjistruara. Janë hasur 167 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt, ndërsa me automjetin e posaçëm janë marrë 125 automjete. Policia rrugore sanksionoi edhe një këmbësor, si dhe shtatë vozitës për kalim në dritë të kuqe të semaforit, gjashtë se nuk u kanë dhënë përparësi këmbësorëve, pesë për reshtim të parregullt dhe dy për tejkalim të parregullt. (O.XH)

Lirohet diseli, shtrenjtohet eurosUPER 95

Shkup, 5 shkurt - Çmimet e diselit derivateve prej të hënës në mesnatë lirohen për një denar, ndërsa benzinat EURO-SUPER BS-95 shtrenjtohet për gjysmë denari për litër, vendosi sot Komisioni Rregullator për Energjetikë (KRRE). Me vendimin realizohet ulje e çmimit rafinerike dhe me pakicë të derivateve të naftës në mesatare për 1.59, gjegjë-

sisht për 1.21 për qind. Çmimi i ri me pakicë i EURO-SUPER BS-95 do të jetë 68, ndërsa çmimi i i benzines EURO-SUPER BS-98 është i pandryshuar, gjegjësisht 69.5 denarë për litër. EURO-DISEL (D-E V) do të shitet për 59.5, ndërsa Vaji ekstra i lehtë për amvisëri (EL-1) për 48 denarë për litër. Me vendimin e KRRE-së për 0.807 për kilogram

ulet edhe çmimi me pakicë i mazutit M-1 NS dhe do të jetë 29.099 denarë. Si arsye për ndryshimin e çmimit me pakicë të derivateve të naftës nga KRRE i theksojnë për 0.7 për qind çmimi më i ulët mesatar i naftës së papërpunuar në tregun botëror në 14 ditët e kaluara dhe për 1.28 për qind kursi më i ulët në krahasim me denarin.

NËSE LIGJI NUK KORRIGJOHET NË PJESËN E AKREDITIMEVE

FAKULTETE ME PROFESORË, POR QË NUK KANË STUDENTË

Pjesa e akreditimit të programeve studimore nga njëra anë dhe nga ana tjetër kushtet për marrjen e thirrjeve shkencore rrezikojnë ta vënë Ligjin e ri të arsimit të lartë në pozita regresive. Bashkim Ziberi, profesor universitar dhe anëtarë i Këshillit për Akreditim, thotë se jo gjithçka në Ligjin aktual është për t'u ndryshuar

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 5 shkurt - Ndryshimet që pritet të sjell Ligji i ri i arsimit të lartë në Maqedoni, përveçse i mirëpritur - mund të rezultojë edhe të kontestohet në pjesë të veçanta, sikurse është edhe çështja e akreditimit. Ndryshimet e propozuara në këtë pikë rrezikojnë ta bëjnë çështjen e akreditimeve një proces të ngurtë në aspektin formal dhe çfarë është më shqetësuese - regresiv në aspektin formal. Profesi universitar Bashkim Ziberi mendon se Ligji i ri duhet të jetë shumë më fleksibil në procedurat për akreditimin e programeve dhe profileve



studimore brenda fakulteteve veçmë të akredituara paraprakisht. As kriteret e rritura për numrin e profesorëve që duhet të disponojnë fakultetet gjegjëse, sipas tij, nuk përbëjnë kriterin e domosdoshëm për studime cilësore. Cilësia, thotë Ziberi, nuk matet me numra, por me kriteret që përcaktojnë cilësinë e programit studimor, lidhjeve që ka ai me tregun e punës dhe mbi të gjitha - me performancën akademike të profesorëve të angazhuar në atë fakultet.

Akreditimet e programeve studimore dhe fakulteteve si tërësi, siç dihet - bëhen në çdo pesë vjet, kurse në rastin e kërkesave për hapjen e një programi të ri apo të një profili brenda atij vlejnë të njëjtat kërkesa dhe procedura si për akreditimet e para. Donë të thotë, fakulteti duhet të ketë të punësuar profesorë për 70 për qind të lëndë-

ve të atij programi apo profili. E shprehur në numra, duhet që fakulteti të ketë punësuar paraprakisht 10 profesorë me marrëdhënie të rregullt pune për programin apo profilin të cilin kërkon ta akreditojë. Problemi, sipas Ziberit, është se askush nuk mund ta di paraprakisht nëse do të krijohen kushte për funksionimin e atij programi studimor. "Funksionimi i një programi varet në radhë të parë nga numri i studentëve. Askush nuk mund ta dijë se cilat do të jenë prurjet në fjalë, sepse mund të ndodh që të mos ketë interesim dhe të mos regjistrohen studentë të mjaftueshëm për fillimin me punë të atij programi. Prandaj, fakulteti nuk mund të rrezikojnë dhe të punësojnë 10 profesorë pa ditur nëse do të kenë studentë atë vit ose jo. Këtu lind pyetja, çfarë më pastaj, pra çfarë do të bëjnë

fakultetet me profesorët që veçmë kanë qenë të detyruar ti punësojnë". Ziberi, i cili është edhe anëtarë i Këshillit për Akreditim dhe Evaluim të Institucioneve të Larta Arsimore në Maqedoni, është i mendimit se në këtë pikë, Ligji i ri duhet tu qëndrojë kriterëve të Ligjit aktual, pra që për akreditimin e një programi të ri, fakulteti të disponojë kuadër për 50 për qind të lëndëve dhe jo për 70 për qind siç kërkohet me Propozim-ligjin e arsimit të lartë. Nëse ndodh ndryshimi, më së keqi thotë se do ta pësojnë universitetet në gjuhën shqipe, pasi janë më të reja dhe relativisht më të vogla. Për shkak të kësaj, e kanë më të vështirë edhe manovrimin me kuadrin e punësuar.

Një element tjetër ku ai sheh dobësi në këtë Propozim-ligj është edhe përcaktimi i kriterëve të

performancës akademike. Në kohën kur me Propozim-ligjin e rriten kriteret për numrin e profesorëve të punësuar, ulet kriteri i kontributit akademik, nënvizon Ziberi, duke uruar që gjatë rrugës - Ligji të korrigjohet në këtë pikë. "Një element ku janë zbehur shumë kriteret janë kushtet për marrjen e thirrjeve shkencore. Për fat të keq, nuk jam dakord me propozimin aktual, sepse për të marrë thirrjen docent, kërkohet që kandidati të ketë katër punime me karakter ndërkombëtar (qofshin publikime ose prezantime të konferencave të rregullta) të botuara në revistat e shteteve të Bashkimit Evropian ose vendeve të OECD-së". Këto punime duhet të jenë të indeksuara në "Web on-science" që është në rregull, plotëson më tej ai. Por, përveçse në "Web on-science", propozim-ligji e lejon që ato punime të jenë të indeksuara edhe në "indeks copernicus" dhe që sipas Ziberit, është një portal në të cilin gjenden të gjitha llojet e revistave brenda saj, apo sikurse shprehet ai, "një indeksim on-line i të gjitha revistave shkencore, por ku vetë nuk kanë kontroll për numrin e revistave që kanë në gjirin e vet". Ndryshimet thotë se duhet të mendohen mirë para se të miratohen në Parlament me qëllim që të mos vijmë në situatë që Ligji të ketë nevojën e ndryshimeve dhe plotësime nga dy herë në vit, sikurse është vepruar deri tani.

"Vitin e kaluar kishim 8 prishje të rendit publik, ndërsa sivjet vetëm 7 dhe ajo tendencë e jona për të arritur këtë numër njëshifëror u arrit, mirëpo nevojitet që gjithnjë e më tepër të tentojmë që ky numër sa më shumë të minimalizohet dhe pse të mos kemi fare prishje të rendit dhe qetësisë publike në shkolla dhe përreth shkollave tona", thotë Qazimi

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 5 shkurt - Bashkëpunimi midis institucioneve për të garantuar sigurinë e fëmijëve në shkollat fillore dhe të mesme ka ndikuar pozitivisht në zvogëlimin e numrit të prishjes së rendit dhe qetësisë publike nëpër shkollat fillore dhe të mesme të Tetovës, megjithatë kjo dukuri edhe më tutje vazhdon të jetë e pranishme nëpër shkolla, ku gjatë vitit të kaluar janë regjistruar

MË PAK INCIDENTE NË SHKOLLAT E TETOVË

SIGURIA NË SHKOLLA, SFIDË SERIOZE E INSTITUCIONEVE



15 prishje të rendit dhe qetësisë publike në shkollat fillore dhe të mesme, gjegjësisht një më pak nga viti 2016, nga të cilat shtatë kanë ndodhur në shkollat e Tetovës dhe tetë në shkollat e Gostivarit. Një nga prioritetet e Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë vitin e kaluar ishte rendi dhe qetësia publike në dhe përreth shkollave fillore dhe të mesme në rajon. Në krahasim me vitet e kaluara, numri i prishjes së rendit dhe qetësisë publike shënon një zvogëlim të dukshëm, por edhe

pasojat përfundimtare të prishjeve të rendit dhe qetësisë publike në krahasim me vitet e kaluara janë më të lehta. Një gjë të tillë e konfirmojnë edhe nga Sektori për Arsim pranë Komunës së Tetovës, nga ku thonë se për dallim nga e kaluara, viteve të fundit kemi të bëjmë me më shumë siguri nëpër shkolla dhe me më pak prishje të rendit dhe qetësisë publike. "Përdërisa në vitin 2013 prishja e rendit dhe qetësisë publike përreth shkollave ishte në një shifër afërsisht 30 prishje të rendit dhe qetësi-

së publike, vitin e kaluar e përfundam me shtatë prishje të rendit dhe qetësisë publike në shkollat dhe përreth shkollave të Tetovës. Kjo ishte edhe një nga synimet tona që periodikisht të kemi ulje të prishjes së rendit publik dhe të arrijmë në një shifër prej njëshifëror. Kështu që vitin e kaluar kishim 8 prishje të rendit publik, ndërsa sivjet vetëm 7 dhe ajo tendencë e jona për të arritur këtë numër njëshifëror u arrit, mirëpo nevojitet që gjithnjë e më tepër të tentojmë që ky numër sa më shumë të minimalizohet dhe pse të mos kemi fare prishje të rendit dhe qetësisë publike në shkolla dhe përreth shkollave tona. Në këtë drejtim janë ndërmarrë masa të shumta si e para gati se në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme janë vendosur kamera të sigurisë në dhe jashtë objekteve shkollore", deklaroi Ahmet Qazimi, udhëheqës i Sektorit për Arsim në Komunën e Tetovës. Ai thotë se janë rritur masat e sigurisë në

brendi të objekteve shkollore, është përforcuar kujdestaria ditore janë shtuar edhe komunikimet një nga një me prindërit si dhe me Këshillin e prindërve. Po ashtu, shprehet më tej Qazimi, edhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme kemi realizuar shumë projekte edukative me qëllim që të bëhet preventimi i këtyre dukurive jo të hijshme me qëllim që gjithnjë e më tepër nxënësit të jenë të vetëdijshëm për vlerën që e posedojnë për shëndëtinë e tyre dhe gjithnjë e më tepër të evitohen dhe të mos kemi prishje të rendit dhe qetësisë publike në shkolla dhe përreth shkollave. Ndryshe, pjesëtarë të policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë çdo ditë kanë qenë prezent rreth shkollave fillore dhe të mesme, veçanërisht në kohën e pushimeve të gjata, dhe ndërrimeve të nxënësve, ndërsa kjo praktikë vijon edhe më tutje. Përveç kësaj, nëpër shkolla janë realizuar edhe rreth dhjetë projekte preventive-edukative.

DËMSHPËRBLIMET NË MUAJIN SHKURT

30 MILIONË EURO DËM NGA NDRYSHIMET KLIMATIKE

Në Maqedoni, vetëm vitin e kaluar janë shkaktuar dëme të mëdha në prodhimtarinë e mollës, rrushit, pemëve të llojeve të ndryshme, orizit... Në seancën qeveritare të radhës është paralajmëruar përcaktimi i përqindjes së kompensimit për bujqit, pas çka deri në fund të muajit do të fillojë edhe pagesa e bujqve



Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 5 shkurt - Ndryshimet klimatike si thatësira dhe dukuritë ekstreme tjera të motit vitet e fundit dëmtojnë mjaft bujqësinë jo vetëm në Maqedoni, por edhe më gjerë. Tendencat e zvogëlimit të reshjeve, breshrit, si dhe të mbulesës së dëborës dhe thatësirës gjatë kohës kur priten reshje, e ngricave të mëdha e kështu me radhë, si problem shqetëson të gjithë bujqit, por edhe ekonominë nacionale për shkak se shkakton humbje të mëdha për prodhimtarinë bujqësore.

Në Maqedoni vetëm vitin e kaluar janë shkaktuar dëme të mëdha në prodhimtarinë e mollës, rrushit, pemëtari të llojeve të ndryshme, orizit... Javë më parë, ministri i Bujqësisë, Ljupço Nikollovski në seancën parlamentare kushtuar pyetjeve të deputetëve theksoi se dëmet e bujqve nga ndryshimet klimatike vitin e kaluar vlerësohen në 30 milionë euro. Sipas tij, në seancën qeveritare të radhës pritet që të përcaktohet përqindja e kompensimit për bujqit, pas çka në këtë muaj do të fillojnë edhe pagesat e bujqve. Për dëmet e mëdha nga ndryshimet klimatike në bujqësi janë ankuar edhe shtetet fqinje. Në Kosovë, vitin e kaluar në komuna të ndryshme janë raportuar dëme të mëdha nga moti i keq. Vetëm në Komunën e Rahovecit vlerësohet se moti i ftohtë shkaktoi 3 milionë euro dëme në vreshtat e këtij rajoni. Miliona euro dëme janë shkaktuar nga ngricat në pemëtarinë dukagjinase.

Gjithashtu, thatësira e tejzgja-

tur në Shqipëri gjatë vitit 2017 i ka shkatërruar plotësisht gjysmën e sipërfaqeve të mbjella në ara dhe drufrutorë. Analizat tregojnë se kulturat më të prekura nga moti me temperatura ekstreme të larta dhe mungesë reshjesh për më shumë se 70 ditë janë misri, perimet, jonxha dhe dëme të tjera në pemëtari, vreshta, ullinj dhe agrume. Në Serbinë fqinje me potencialin më të madh bujqësor në rajon, si rrjedhojë e ndryshimeve klimatike përgjatë periudhës 2000 deri në vitin 2015 janë shkaktuar dëme në vlerë prej 5 miliardë euro, tregojnë analizat zyrtare. Më shumë se 70 për qind e humbjeve në bujqësi janë shkaktuar nga thatësia dhe temperaturat e larta, ndërsa vërshimet ishin shkaku i dytë i dëmeve të mëdha.

Nga ana tjetër, agronomët vlerësojnë se në Maqedoni, parcelat e vogla bujqësore janë faktor tjetër që vështirësojnë adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike. Kështu që, fermeri vendor nuk është në gjendje financiare as të adaptohet e as të informohet me kohë për këtë problematikë. Më e goditur në Maqedoni nga ky fenomen është rajoni qendror i rrjedhës së Vardarit si më i thati në rajon, ndërsa ndikime negative ka edhe në Pollog, Pellagoni apo Strumicë, ku ushqimi prodhohet në mënyrë intensive.

"Masat që duhet të ndërmerren janë të njohura dhe fermerët zbatojnë një pjesë të tyre si vaditja pikë për pikë, por ato shpesh nuk kanë qasje të mjaftueshme ndaj këtyre masave. Gjithashtu, nevojitet që



Në Serbinë fqinje me potencialin më të madh bujqësor në rajon, si rrjedhojë e ndryshimeve klimatike përgjatë periudhës 2000 deri në vitin 2015 janë shkaktuar dëme në vlerë prej 5 miliardë euro, tregojnë analizat zyrtare. Më shumë se 70 për qind e humbjeve në bujqësi janë shkaktuar nga thatësia dhe temperaturat e larta, ndërsa vërshimet ishin shkaku i dytë i dëmeve të mëdha



Në Kosovë, vitin e kaluar në komuna të ndryshme janë raportuar dëme të mëdha nga moti i keq. Vetëm në Komunën e Rahovecit vlerësohet se moti i ftohtë shkaktoi 3 milionë euro dëme në vreshtat e këtij rajoni. Miliona euro dëme janë shkaktuar nga ngricat në pemëtarinë e Dukagjinit

edhe adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike të përfshihen në masat e ndryshme që ndihmojnë punën e bujqve përmes subvencioneve", thotë profesori universitar Ordan Çukaliev.

Sipas tij, ndër masat e adaptimit

të fermerëve janë ato që mund ti ndërmarrin vetë ata siç janë mbjelljet më të hershme - me qëllim që ti iket periudhave më të thata dhe të nxehta kur kulturat dëmtohen më së shumti, si dhe vaditja apo siguri mi i sasive më të mëdha të ujit për vaditje. Nevojitet edhe mbjellja më e thellë e kështu me radhë. Ekspertët shtojnë se për të gjithë rajonin, por edhe bujqësinë në botë - nuk do të jetë një sfidë e lehtë që të organizohet prodhimi bujqësor ndaj ndryshimeve të mëdha klimatike, ku për çdo vit shënohen periudha të gjata me thatësi, si dhe shpërndarje jo e barabartë e sasive të reshjeve të shiut që kanë zvogëluar rendimentet gati të të gjithë kulturave bujqësore. Sipas ekspertit bujqësor, Branislava Laliç, problem tjetër për bujqësinë paraqet edhe fakti se po ndryshon orari i reshjeve përgjatë mbjelljeve dhe korreve të kulturave të ndryshme bujqësore në vitet e fundit. "Nuk është njësoj kur sasia mujore e reshjeve shpërndahet në disa ditë mesatare me shi përgjatë muajit ose shiu do të derdh për një pasdite, ndërsa në 30 ditët e mbetura nuk kemi asnjë pikë shi. Andaj ekonomizimi me ujë e disponueshëm do të jetë një nga detyrat kryesore për qëndrueshmërinë e prodhimtarisë bujqësore", shton më tej Laliç. Sipas saj, çdo bujk, por edhe blegtor duhet ti kushtojë një rëndësi më të madhe edukimeve dhe trajnimeve shtesë, si dhe ndjekjes së këshillave profesionale të ekspertëve për shkak se në të ardhmen, fermerët do të kujdesen sa vjen e më shumë për kushtet ekstreme të motit dhe pasojat e tij.

Eksporti shënon rritje prej 18.5 për qind

Shkup, 5 shkurt - Vlera e mallrave të eksportuara nga Maqedonia vitin e kaluar arrin 5.671.466 mijë dollarë amerikanë dhe shënon rritje prej 18,5 për qind në krahasim me vitin paraprak. Vlera e mallit të importuar, në periudhën e njëjtë, arrin 7.719.852 mijë dollarë amerikanë, që është për 14,2 për qind më shumë në krahasim me vitin paraprak, publikoi Enti Shtetëror i Statistikës. Sipas të dhënave të publikuara, deficitit tregtar në periudhën janar-dhjetor të vitit 2017, arrin 2.048.386 mijë dollarë amerikan, ndërsa mbulimi i importit me eksportin arrin 73,4 për qind. Nga Maqedonia më së shumti janë eksportuar katalizatorët e trans-

portuesve të metalit të çmuar ose komponimet e tyre, setet e përcuesve për ndezje dhe ngjashëm, për automjete, aeroplanë ose anije, automjete motorike për transport të 10 ose më shumë personave, duke përfshirë edhe shoferin, me motor me djegie të brendshme me ndezje me ndihmën e kompresimit (dizel ose gjysmëdizel) dhe veshmbathje. Gjatë vitit të kaluar më së shumti janë importuar platini dhe lidhjet e platinës, të papërpunuara ose në formë të pluhurit, vajrat e naftës dhe vajrat e fituara nga mineralet bituminoze (përveç të papërpunuara), metale të tjera nga grupi i platinës dhe lidhjet e tyre, të papërpunuara ose në formë të pluhurit dhe prodhimet e ferkëtuarra të hekurit ose çeliku i papërzier, të papaguara ose të pakoordinuara, të përpunuara me gjerësi prej 600mm ose më shumë. Sipas vëllimit të tërësishëm të këmbimit të jashtëm tregtar, Republika e Maqedonisë më së shumti ka tregtuar me Gjermaninë, Britaninë e Madhe, Greqinë, Serbinë dhe Bullgarinë. Të dhënat tregojnë se eksporti gjatë vitit të kaluar shënon rritje pothuajse të gjitha vendet. Kështu drejt Gjermanisë rritja është 18,4 për qind, Britanisë së Madhe 31,6 për qind, Greqisë 24,6 për qind, Serbisë 15,9 për qind, Bullgarisë 35,1 për qind, Italisë 5,7 për qind, Kinës 30,2 për qind, Turqisë 25,3 për qind, Rumanisë 30,6, Belgjikës gjashtë për qind, Hungarisë 90,4 për qind, Polonisë 81,2 për qind, Kosovës 8, Sllovenisë 15,4, SHBA-së 9,4, Austrisë 64,9 për qind dhe Rusisë 10,6.

Lidhje të forta tregtare me Francën

Shkup, 5 shkurt - Ministri për Investime, Zoran Shapuriq dhe ministrja për Tërheqjen e Investimeve të Huaja, Zorica Apostolska të hënën u takuan me ambasadorin francez në Maqedoni, Kristian Timonie dhe drejtorin e zyrës "Business France" me seli në Athinë, Pier Linjo. Në takim, ashtu siç informon kabinetin i

ministrit Shapuriq, ambasadori Timonie e theksoi interesin e kompanive franceze për rajonin, i përsëriti aspiratat euroatlantike të Republikës së Maqedonisë dhe e përmendi përkrahjen e Francës në këtë proces. Drejtori Linjo e ka prezantuar forumin e ardhshëm ekonomik "Franca-Ballkani 2018" që do

të mbahet në Beograd më 30 dhe 31 maj. Ky, ashtu siç citohet, është forumi i tretë dhe është vazhdim i proceseve të filluara nga Procesi berlines dhe Samiti në Paris. Në forumin ekonomik do të marrin pjesë kompani nga Franca së bashku edhe me 12 delegacione dhe kompani nga vendet e rajonit. Pritet prania e më shumë se

250 pjesëmarrësve, të cilët do të fokusohen në pesë sektorë: agroindustri, infrastrukturë, IT (teknologji të reja), energjetikë me fokus të burimeve të rinovueshme dhe turizëm. "Forumit ekonomik do të paraqesë mundësi të shkëlqyer për kompanitë e Maqedonisë t'i prezantojnë prodhimet e tyre dhe shërbimet me

qëllim që të realizojnë partneritet të biznesit dhe bashkëpunim me kompanitë franceze. Pjesëmarrja e kompanive të Maqedonisë në forumin ekonomik është falas", thuhet në kumtesë. Ambasadori Timonie e ka theksuar vlerën e forumit në procesin e përfortimit të lidhjeve tregtare mes Francës dhe Maqedonisë.

Poroji pa ujë të pijshëm

Tetovë, 5 shkurt - Banorët e fshatit Poroj edhe gjatë ditës së sotme me ujë për pije furnizohen nga çezma e fshatit, për shkak se rrjeti i ujësjellësit të këtij fshatit ditë më parë ka pësuar dëme serioze nga rrëshqitja e dheut dhe të reshurat intensive të shiut. Nga Bashkësia Lokale e këtij fshati thonë se uji në fshatin Poroj edhe më tutje vazhdon të jetë jo i pijshëm, por po punohet në drejtim të riparimit të rrjetit të ujësjellësit dhe deri në sanimin e tërë-

sishëm - do të marrë pak më shumë kohë për shkak se bëhet fjalë për dëmtime pak më serioze. Sa i përket pastrimit të shtratit të lumit nga prurjet e dheut dhe gurëve që sollën vërshimet, kryetari i Bashkësisë Lokale të këtij fshati thotë se në këtë drejtim komuna ka angazhuar një ekskavator dhe disa kamionë, të cilët shtratin e lumit e pastrojnë vetëm në pjesën e poshtme të fshatit, gjegjësisht në magjistralen Tetovë-Jazhincë, konkretisht tek ura

që të mos rrezikohet bllokimi i urës, ndërsa në pjesën lartë nuk janë ndërmarrë masa për pastrimin e shtratit të lumit. Ndërkohë, rruga lokale deri në vendin Banjat në Tetovës mbrëmë sërish është mbuluar nga shkëmbinjët dhe dheu, me çrast edhe sot është dashur të intervenohet. Nga Qendra për Menaxhim me Kriza informojnë se gjatë ditës së djeshme me ekskavator është intervenuar në rrugën lokale, e cila çon drejt vendit Banjat



e Tetovës që ishte e mbuluar nga shembja e dheut dhe nga gurët. Rruga, siç theksojnë, është pastruar, por rreth orës 20:30 është marrë njoftim se e njëjta është mbuluar sërish nga shkëmbinjët e mëdhenj dhe dheu. Nga ana e Qendrës për Menaxhim me Kriza

në Tetovë është njoftuar Shtabi i krizave i Komunës së Tetovës nga ku është marrë informata se do të intervenohet në orët e mëngjesit për shkak të sigurisë, sepse rruga është me konfiguracion mjaft të keq dhe nga njëra anë ka humnerë të lartë. (U.H)

EEN MAQEDONI PUBLIKON RAPORTIN

TË SHFRYTËZOHEN PROGRAMET EVROPIANE

Në Rrjetin Evropian të Mundësive të Biznesit janë përfshirë 600 organizata partneriteti dhe mbi 3.000 ekspertë. Mesatarisht 52.000 ndërmarrje të vogla dhe të mesme për çdo ditë të fitojë këshilla prej ekspertëve nga rrejtja në drejtim të avancimit të inovacioneve, rritjes dhe internacionalizimit të tyre



Shkup, 5 shkurt - Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme vendore duhet të paraqiten më shumë për pjesëmarrje në projekte të financuara me programet e Bashkimit Evropian, duke pasur parasysh kapacitetin dhe interesin për bashkëpunim me ato nga kompanitë e huaja. Këtë e rekomanduan të

hënën nga Rrjeti Evropian i Mundësive të Biznesit në Maqedoni (EEN Maqedoni), pjesë e rrjetit më të madh për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, i cili është i përfshirë në programet evropiane KOSME dhe Horizont, që kompanive u ofron ndihmë në shfrytëzimin e mundësive nga tregu evropian. Të dhënat nga EEN Maqedoni tregojnë se u nisur nga fusha me interes më të madh dhe shkallë të suksesit kanë firmat nga sfera e TIK. Viktor Stojmanovski, projekt menaxher

në EEN Maqedoni, shpreson se këtë vit do të ketë përfitim të drejtpërdrejtë nga Instrumenti për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. "Në nivelin e tërë rrjetit të asaj që është paraqitur dhe asaj që është arritur shkalla e suksesit është pesë për qind. Islanda është jashtëzakonisht e suksesshme me 13 për qind. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të Maqedonisë duhet më shumë të paraqiten, ndërsa ata që janë paraqitur evaluim kalojnë mirë. Shpresojmë që këtë vit do të

kemi përfitim të drejtpërdrejtë nga Instrumenti për ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Në fushat e tjera gjenden dhe paraqiten", tha në konferencën për media Stojmanovski. Në Rrjetin Evropian të Mundësive të Biznesit janë përfshirë 600 organizata partneriteti dhe mbi 3.000 ekspertë. Mesatarisht 52.000 ndërmarrje të vogla dhe të mesme për çdo ditë të fitojë këshilla prej ekspertëve nga rrejtja në drejtim të avancimit të inovacioneve, rritjes dhe internacionalizimit të tyre.

Ndotja e ajrit në Kumanovë, spërkaten rrugët


Kumanovë, 5 shkurt - Rrugët në Kumanovë do të spërkaten që të ulet ndotja e ajrit, informuan të hënën nga sektori për marrëdhënie me publikun të komunës së Kumanovës. Spërkatja e rrugëve do të fillojë prej nesër dhe do ta zbatojnë shërbimet komunale në bashkëpunim me fakultetet për shkencë bujqësore dhe ushqim dhe për teknologji informatike dhe të komunikimit, si pjesë e masave të cilat ndërmerren për uljen e ndotjes së ajrit në qytet. Spërkatja do të kryhet në orët e natës, nga ora 20:00 deri në orën 01:00 pas mesnate. "Pajisja e quajtur Atonizer me të cilën do të zbatohet metoda do të vendoset në një rimorkio traktori dhe do të shoqërohet nga një automjet i MPB-së, gjatë spërkatjes së rrugëve. Me këtë metodë do të kryhet përfshirja e PM10 grimcave të cilat grumbullohen në rrugë", theksohet në kumtesën e komunës së Kumanovës. Personat profesionistë do të kryejnë matje të përqendrimit të PM10 grimcave para dhe pas spërkatjes dhe do të bëhet analizë e rezultateve të cilat do të prezantohen para opinionit më të gjerë. Nëse kjo metodë tregohet si e suksesshme, thonë nga komuna e Kumanovës, ajo do të zbatohet edhe në të ardhmen në kuadër të planit të akcizës për uljen e ndotjes së ajrit e cila përfshin një seri masash, midis të cilave edhe subvencione për përfshirje e rrjetit të gazsjellësit, mbjellje të fidanëve, mbikëqyrje inspektuese.

Dy familje pa kulm mbi kokë nga erozioni i dheut

Tetovë, 5 shkurt - Dy familje që jetojnë në afërsi të varrezave ortodokse në Tetovë kanë mbetur në qiell të hapur për shkak se erozioni i dheut nga të reshurat e shiut ka shembur shtëpinë e Iلمي Imerit, ndërsa shtëpia e fqinjëve të tij - poashtu rrezikon që të shembet dhe nuk është e sigurt për banim. Fatmirësisht, shembjen e murit mbi shtëpinë e Iلمي Imerit në kohë e kanë vërejtur fqinjët e tij, të cilët e kanë njoftuar në kohë për të dalë

nga shtëpia. "Shtëpia është shkatërruar e tëra, nuk di se ku do të flemë, natën e kam kaluar tek fqinjët, ne përgjithësisht në këtë lagje jemi raste sociale dhe kërkojmë ndihmë nga shteti apo komuna që të na ndihmojnë për të sanuar shtëpinë nëse e njëjta mund të sanohet", thotë kryefamiljari Imeri. Përveç shtëpisë së Imerit, dëme ka pasur edhe në shtëpitë e fqinjëve të tij, të cilët thonë se nga erozioni i dheut, mu-

ret e shtëpisë kanë pësuar çarje dhe kanë frikë që të banojnë në të njëjtat për shkak se paraqesin rrezik potencial për shembjen e tyre. Nga Komuna e Tetovës përmes një komunikate me shkrim njoftuan se në kuadër të mundësive të tyre do të mundohen që të gjejnë një zgjidhje për të ndihmuar familjen Imeri, por edhe për të gjetur një zgjidhje për parandalimin e rrëshqitjes së dheut ku mund të pësojnë edhe shtëpi të tjera përreth. (U.H)



“Njeriu” i djathtë dhe “humanizmi” i majtë



Nga Fitim ZEKTHI

Gjithkujt i ndodh të vrasë mendjen se çfarë është në gjendje të bëjë njeriu, deri në ç'gremina “njerëzore” apo morale mund ta çojë ai veten dhe pse? Kjo vramendje bëhet padyshim më e shpeshtë dhe torturose kur sheh se si njerëzit kapen me thonj pas interesit të ngushtë duke u bërë servilë të pështrirë apo duke u kthyer në armiq të paepshëm vetëm për një post, një detyrë, një kandidaturë deputeti, ambasadori etj. Shumë torturose bëhet kur sheh njerëz që nginjen apo të tjerë që nuk nginjen së nginjuri duke vjedhur tenderë, koncesione, para të njerëzve të thjeshtë të cilët jetojnë në baltë pa ushqim ose ilaçe dhe me dhimbjen e pashtershme të prindërve teksa nuk munden t'u japin fëmijëve këtë gjë kaq elementare. E njëjta shungullimë përplaset mendjes kur njerëz që kanë qenë për vite me radhë drejtues në administratë apo agjenci publike pasi kanë ndërtuar vila me ato para sillen si të ndershëm, përbetohen se janë të varfër dhe synojnë të bëhen deputetë për të ndihmuar këtë vend. Kur nuk bëhen shpërthejnë në luftë ndaj atij që nuk i bëri. E keqja shfaqet në forma edhe më të rënda si ajo e përdorimit të mësueses që nuk kishte ilaç për sëmundjen e tumorit duke e sjellë në Tiranë para kamerave për të treguar se ka një “njeri që lejon jetën ose të lejon të vdesësh” apo ajo e kryetarit të Bashkisë që thotë se e ka bërë dasmën me kursimet nga pensioni i nënës etj.

Dhuna e tmerrshme dhe djallëzore e vrasjes së gruas apo vëllait, e vrasjes së nënës apo babait apo bombardimet e qyteteve, gjenocidi, refugjatët që lihen në mes qiellit dhe detit padyshim që e bëjnë çdo njeri të meditojë se ç'është në fakt natyra njerëzore. Mendimtarë të shumtë, tekste filozofike, teologjike etj., kanë folur gjatë mbi natyrën e njeriut. Nisur nga dhuna e madhe, luftërat, mizoritë, kampet e përqendrimit, perversionet, vrapimi pas epsheve shumëkush mund të priret të mendojë se njeriu është në fakt një egërsisë. Në kohët moderne këtë pikëpamje e mbrojtën mendimtarë të shquar si Freud, Nietzsche etj. Ndërkohë që ata që janë quajtur humanistë e besojnë njeriun të mirë, e ngrënë atë në gjendjen engjëlllore. Mendimi më zotëruar veçanërisht në besimet fetare (sidomos atë islam) është se njeriu qëndron në mes, se gjendet mes djallëzores dhe engjëlllores dhe se ka potencialin të shndërrohet në njërin nga të dyja.

Pikërisht kjo gjë e bën njeriun të jetë një nga krijesat më të veçanta.

Ndryshe nga engjëjt, bimët, pemët, kafshët etj., njeriu mund të zgjedhë të jetë i mirë ose i keq. Ai mund të jetë i dhembshur në rastin që zgjedh të jetë mizor, ai mund të jetë shkatërrimtar, agresiv i dhunshëm në momentin kur ne presin që ai të jetë i mirë dhe fisnik. Njerëzit mund të përipiqen të nxënë, studiojnë dhe bëjnë punë shumë të mira por ata mund të rrinë kot, të tallin të tjerët, të bëhen idiotë dhe të mos kenë asnjë dëshirë të sillen sikur kanë diçka tjetër veç mishit. Mund të jenë inteligjentë, njerëz që mendojnë, arsyetojnë ose mund të jenë kokëbosh nga ata që janë lëndë e parë e asaj që Hannah Arendt e quante banaliteti i së keqes (ky lloj njeriu prodhoi monstrat që kryen krimet në komunizëm dhe fashizëm). Pra, njeriu mund të jetë mëkëmbës i Zotit në tokë i ngarkuar me detyrën e dëshmitit të Tij dhe me mbrojtjen e të drejtës dhe të mirës. Kjo është pika në të cilën njeriu është krijesë e veçantë e Zotit dhe këtij njeriu i janë përlulur edhe engjëjt.

Fetë e mëdha monoteiste besojnë se ky është njeriu të cilit i ka folur Zoti përmes zbulësës dhe profetëve dhe kjo është krijesa që Ai do dhe mbron. Nga ana tjetër gjendet njeriu lakmitar, i pangishëm, shkatërrues, epshndjekës dhe jo inteligjent që mund të shkatërrojë veten por mund

të dëmtojë deri në shkatërrim edhe krijimin. Misteri i vullnetit të lirë, mister i pyetjeve madhore si zgjedh dhe çfarë zgjedh njeriu, krijon pandalur një gjendje konstante tensioni, gjendje që e dallon njeriun nga pjesa tjetër e krijimit. Ka një dinamikë të vazhdueshme e cila është shtrati në të cilin inteligjenca dhe vullneti i lirë e çon njeriun drejt mirësisë, të ndershmes, të drejtës apo drejt vesis, vetëkënaqësisë, vetëlavdërimit, pangopjes etj. Sigurisht njeriu nuk është engjëll por nuk është as djall dhe pikërisht kjo është arsyeja pse ai është aq i veçantë. James Madison, një nga etërrit themelues të SHBA-së dhe një filozof i rrallë i ligjit thotë se në qoftë se njerëzit do të ishin engjëj nuk do të na duheshin as ligje, as rregulla, as institucione nuk do na duhej asgjë. Në qoftë se njerëzit do të ishin engjëj ata nuk do të ngarkoheshin me detyrën e përdorimit të inteligjencës dhe të vullnetit të lirë për të kërkuar të mirën dhe të vërtetën. Ky është fati i njeriut, një fat që e fut atë në një zinxhir të madh qeniesh. Pra, njeriu nuk është egërsirë por ai ka mundësinë të jetë edhe më i keq se një egërsirë. Një egërsirë nuk ka vullnet të lirë dhe nuk ka as inteligjencë si ajo e njeriut. Një egërsirë udhëhiqet nga nevojat dhe dëshirat fizike. Duke keqpërdorur ose mospërdorur inteligjencën dhe duke rënë

Njerëzit mund të përipiqen të nxënë, studiojnë dhe bëjnë punë shumë të mira por ata mund të rrinë kot, të tallin të tjerët, të bëhen idiotë dhe të mos kenë asnjë dëshirë të sillen sikur kanë diçka tjetër veç mishit



tek dëshirat dhe nevojat fizike, njeriu mund të bëhet më keq se një kafshë. I takon të zgjedhë. Përdërisa vetëm njeriu mund të zgjedhë mes të mirës dhe keqes atëherë vetëm për të ekziston shpërblimi dhe ndëshkimi. Gjithë thelbi qëndron te përdorimi i drejtë i vullnetit të lirë dhe i inteligjencës. Është e qartë se gjendja e sotme në parlament, politikë, ekonomi, shkollë, spitale dhe kudo mund të jetë shumë më mirë vetëm duke përdorur inteligjencën dhe vullnetin e lirë. Pa dashur të hyjmë në dallime ideologjike duhet thënë se e djathta dhe konservatorizmi gjenden bash në rrënjë të këtij këndvështrimi. Për të majtën në thelb nuk ka fare vullnet të lirë. Njeriu është një makinë biomolekulare dhe nuk ka fare nevojë të zgjedhë mes të mirës dhe të keqes. Madje as nuk mund të zgjedhë. Ai thjesht duhet të ndërtojë me arsye një shtet që i mundëson atij të shprehet apo vetërealizohet plotësisht duke e caktuar vetë se çfarë është morali. E majta është mbrojtëse e humanizmit i cili vë në qendër njeriun si masë të gjithçkaje duke e shkatërruar kësajsoj njeriun. Humanizmi nuk është i mirë për faktin se ka fjalën humanizëm brenda. Ai nënkupton një botë pa Zot dhe një njeri të ardhur këtu vetvetiu, i cili është në qendër dhe duhet të ketë po veten në qendër të kësaj bote.

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 5 shkurt | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Tradita fetare në Shqipëri dhe ekstremizmi

Nga Jona KOPRENCKA



Në botën e globalizuar në të cilën jetojmë gjithçka prek gjithkënd. Me ardhjen e shekullit të ri ndarja e krijuar Perëndim-Lindje, vende të zhvilluara-vende në zhvillim ose të botës së tretë duket se e ka humbur vijën ndarëse (britannica.com). Në këtë përditësim global të fenomeneve të ndryshme, edhe mbi çështjen e ekstremizmit, informacioni nuk mungon



Fatkeqësisht, ngjarjet e negative janë ato të cilat jo vetëm që zënë më shumë hapësirë mediatike, por edhe influencojnë më tepër. Për të qëndruar në këtë temë, një nga ngjarjet më të diskutuara nga vitet 2000 e deri më sot është ekstremizmi. Një fenomen ky i lënë në hijë, por që pas sulmeve të Kullave Binjake në 11 shtator të vitit 2001 u kthye në kryetemën e sigurisë. Këto sulme të kryera nën petkun e një propagande ekstremiste dhe terroriste sollën në jetë konceptin e ri 'Luftë mbi Ekstremizmin dhe Terrorizmin'.

Pasojat e këtyre sulmeve, por mbi të gjitha të asaj çka ato sollën më vonë në vitin 2001 do të ishin të paimagjinueshme. Lufta mbi ekstremizmin do të vijonte të bëhej akoma më prekshme në qershor të vitit 2014 (www.vox.com), kur lisi nga një grup rajonal shpalli kalifatin e tij duke u vetëshpallur 'Shteti Islamik i Irakut dhe i Sirisë'. Nga kjo shpallje zyrtare e një shteti duke propaganduar frymën fetare, situata u ndërlikua akoma më shumë, kur aktivitetet e tij terroriste dhe ekstremiste u përhapën në

pjesën tjetër të botës.

Sulme të panumërta në Stamboll, Ankara, Paris, Bruksel, Marsejë, Barcelonë, Londër, San Bernardino etj propagandojnë frymën e ekstremizmit fetar. Të quajtura si kuazë fetare (islame) këto sulme kërkojnë të bëjnë ndarjen ideologjike Perëndim-Lindje dhe përçarje mes Islamit dhe besimeve të tjera. Kudo ku këto sulme kanë ndodhur është vërejtur një distancim i komunitetit islam dhe i praktikantëve nga ideologjia ekstremiste. Franca, shteti evropian, ku jeton një nga komunitetet më të gjëra Islame, ka bërë një punë që vlen të përmendet për mos-stigmatizmin dhe përplasjen e religjioneve, duke organizuar edhe open-day në disa xhami të vendit (le Figaro.fr).

Nga e gjithë panorama e sipërpërmendur normalisht që vendi ynë, Shqipëria, nuk mund të jetë immune. Në mazhorancë populsi i përket besimit fetar islam dhe normalisht që ekstremizmi është një temë e diskutueshme. Kjo frymë ka depërtuar edhe në vendin tonë, duke bërë që një numër i caktuar qytetarësh të braktisë fa-

miljen dhe vendin e t'i bashkohen kauzës ekstremiste. Edhe pse është një numër relativisht i ulët, në përputhje me numrin e popullatës dhe me të kaluarën tonë, është një shifër që nuk duhet t'i përkiste vendit tonë. Ndryshe nga vendet e tjera, ku është përqaftuar kjo ideologji, shqiptarët, i janë bashkuar asaj kryesisht për arsye ekonomike (për shkak se jetojnë në zona të thella ku kanë një ekonomi të ulët). Familjarët ose miqtë e këtyre luftëtarëve të huaj, të kontaktuar nga institucionet shtetërore ose nga media kanë deklaruar se personi në fjalë ka lënë vendin për shkak se i është ofruar një X shumë të ardhurash. Një faktor tjetër që i ka shtyrë këto persona t'i bashkohen kësaj kauze është mosarsimimi, jetesa në zonat e thella dhe mungesa e jetës social-kulturore (pjesa më e madhe e të larguarve, luftëtarëve të huaj, vijne nga zonë rurale). Këto janë faktorët kryesor që i kanë shtyrë ata pak shqiptarë t'i bashkohen kësaj ideologjie. Edhe në disa forume të mbajtura nga prezenca e OSBE në Shqipëri është përmendur fakti se në Shqipëri ndryshe nga të gjitha

vendet e tjera faktori shtytës kryesor për tu bashkuar me këtë ideologji është ekonomia e dobët (www.osbe.com). Për sa i përket pjesës fetare, shumë e mediatizuar dhe në disa raste pak e kuptuar, nuk ka luajtur rol në përcjelljen e mesazheve të gabuara. Fatmirësisht, ne jemi një vend, gjeografikisht i rrethuar nga popullatë shqiptare dhe ky faktor është mjaft lehtësues në përcjelljen e mesazheve që janë ndërmarrë deri tani në luftën kundër ekstremizmit.

Përpos tolerancës dhe harmonisë fetare për të cilën krenohemi, do të ishte mirë t'i hidhnim një sy historisë. Feja në Shqipëri u bë e lejueshme vetëm pas viteve 1990, kohë në të cilën vendi përqafoi demokracinë. Pas këtyre viteve filloi edhe praktikimi i fesë dhe ndërtimi i kulteve fetare. Në vitet e vështira dhe të errta të diktaturës komuniste, vendi ynë ishte ateist. Besimi në Zot ishte i ndaluar, objektet e kultit, kishat dhe xhamit, u shkatërruar dhe priftërinjtë e hoxhallarët u vranë dhe u burgosën. Në 50 vite diktaturë të flisje për fenë ose të praktikojë ishte e

ndaluar. Por, nëse do të shikojmë historinë para vitete të komunizmit do të vëmë re që ekzistonte po e njëjta frymë tolerance për të cilën ne sot krenohemi. Priftërinj dhe hoxhallarë ishin bashkë në vendimet e marrë në Kuvendin e Prizrenit dhe në Shpalljen e Pavarësisë në Vlorë. "Feja e shqiptarit është shqiptaria" (albavizion.com) shkruan Pashko Vasa, duke e kthyer këtë shprehje në simbolin e bashkëjetesës dhe tolerancës së shqiptarëve. Me një të kaluar kaq të begatë në konceptin e lirisë së religjioneve dhe bashkëjetesës së tyre ndër shekuj, përqaftimi i kësaj ideologjie ekstremiste në kontekstin shqiptar mbetet (nga rastet e vërejtura deri më tani) kryesisht në faktorin ekonomik.

A është mirë me qenë shqiptar?

Nga Desada METAJ



Një marrëveshje e re mes Greqisë dhe Shqipërisë, siç ka ndodhur me thaujse të gjitha marrëveshjet mes dy fqinjëve, u shndërrua në mollën e sherrit mes politikës dhe një pjese të ndjeshme të opinionit publik. Ishin takimet mes dy ministrave të Jashtëm, posaçërisht ai i fundit në Korçë, që ndezën fitilin e zjarrit thaujse të pashuar të debatit politik patriotik shqiptar.

Ndërsa, pala shqiptare u tregua e rezervuar në publikimin e detajeve të takimit, ishte ministri Kotzias ai që informoi publikun grek, po ashtu i ndjeshëm për problematikën e marrëdhënies me shtetin fqinj. Dhe sigurisht që pjesa me delikate, ajo e marrëveshjes detare nga ku buruan dhe akuzat për shitjen apo faljen e territorit shqiptar në këmbim të një mbështetje të Greqisë për hapjen e negociatave, zuri dhe vendin më kryesor në debatin publik të dy ditëve të fundit.

Ajo që dihet me siguri është që Shqipëria do të negociojë një marrë-

veshje të re për përcaktimin e kufijve detarë me Greqinë. Kjo duket krejt normale pas rrëzimit që Gjykatat Kushtetuese i bëri marrëveshjes që qeveria Berisha nënshkroi me palën greke. Një vendim gjykate që, në fakt, shërbeu për shumë kohë dhe si kalë beteje për Edi Ramën, asokohe në opozitë. Me një shikim të shpejtë, pika e parë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese që e shpalli të pavlefshme marrëveshjen e qeverisë Berisha thotë: "Mospajisja e delegacionit shqiptar me plotfuqi të rregullt nga Presidenti i Republikës për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e marrëveshjes".

Por tani që vendet janë këmbyer nuk dihet se si dhe sa ka informuar ministri i Ramës presidentin e vendit. Ky i fundit në një të vetmin reagim, me gjuhë diplomatike dhe të kujdesshme ka deklaruar se po ndjek zhvillimet dhe debatin. Por zyrtarisht, burime të opinion.al bëjnë me dije se ministri i Jashtëm i Shqipërisë nuk ka raportuar ende

zyrtarisht tek kreu i shtetit. Krejt ndryshe nga homologu i tij, që me të mbërritur në Athinë u takua dhe informoi presidentin dhe kryetarin e parlamentit për takimin dy ditor me homologun shqiptar. Ditmir Bushati u detyrua të bënte një deklaratë për shtyp vetëm pasi Kotzias me daljet e tij publike zbardhi detaje të marrëveshjes.

Në fakt, marrëveshja detare, ligji i luftës, pronat e popullsisë çame, varrezat e ushtarëve grekë apo dhe ndryshimet e teksteve shkollorë janë episode patriotike që nuk ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e rrënuar të jetës së shqiptarëve. Të mësuar me skandale ministrash që bashkëjetojnë me krimin, trafikantët dhe korrupsionin, një marrëveshje sado cenuese për disa km vijë bregdetare mund të shërbejë thjesht si thërrime për të peshkuar patriotizmin dhe për të ndezur debatin polifoniko-patriotik. Një sport të preferuar për shqiptarët, që në pjesën më të madhe janë gati të harrojnë

Të mësuar me skandale ministrash që bashkëjetojnë me krimin, trafikantët dhe korrupsionin, një marrëveshje sado cenuese për disa km vijë bregdetare mund të shërbejë thjesht si thërrime për të peshkuar patriotizmin dhe për të ndezur debatin polifoniko-patriotik.



kriminalizimin, vjedhjen nga koncesionet, rritjen e taksave, shëndetësinë e rrënuar, vetëm e vetëm për t'u përfshirë në një debat me patriotë dhe tradhtarë. Që në fakt është thjesht telenovela e radhës, e servitur me kujdes ndërkohë që pjesa më e rëndësishme, marrëveshja e re me Greqinë mbetet e paqartë për të gjithë shqiptarët. Një marrëveshje që mbi të gjitha ka nevojë për transparencë, ekspertë të zotë dhe jo vasalet partish dhe pse jo, bashkëpunimin me të gjithë institucionet përgjegjëse dhe ato kushtetuese. Së paku, për t'u treguar shqiptarëve se për ata që na drejtojnë, patriotizmi nuk është vetëm kisha greke e Dhërmiut që përdoret nga Edi Rama për të marrë vota, as premtimet për pronat e çamëve për të afruar PDIU-në në qeveri. Dhe aq më pak të jetë streha e fundit e një kabineti skandalesh që më shumë se disa km det, ka mbjellë dhe shitur kaq shumë kanabis sa do të mjaftonte të blinte dhe një ishull të pabanuar grek.

PUNËSIMI ILEGAL NË GJERMANI

MASHTRUES DHE TË MASHTRUAR NGA BALLKANI

Dhjetë mijëra njerëz nga Ballkani Perëndimor punojnë në të zeze në Gjermani. Në shumë raste kushtet e punës janë të vështira. Shpesh ata mbeten edhe pa para. Industria mashtruese e "ndërmjetësve" lulëzon



Oferta e punës që iu bë Dino Mehiçit tingëllonte shumë joshëse. Ai duhej të paguante vetëm 200 euro për dhomën nëpërmjet një transferte bankare, dhe duhej të shkonte në Gjermani me shpenzimet e veta. Atje, në fshatin Spiegellau të Bavarisë, e priste një vizë pune dhe një vend pune në sektorin e teknologjisë informative. I riu nga Bosnja nuk u mendua dy herë dhe u nis për Bavari.

Por realiteti ishte krejt ndryshe. Shtëpia ku do të banonte ai ishte një rrënojë, veç tij aty banonin edhe 50 punëtorë të tjerë nga Bosnja, Serbia dhe Kroacia. Shtrati i fjetjes në dhomën e mbushur cyt më cyt kushtonte jo më 200, por 500 euro. Vendi i punës nuk ekzistonte fare. Dino kishte frikë se do të përfundonte si punëtor ilegal në ndërtimtari. Kur "ndërmjetësi" i kërkoi edhe pasaportën, ai vendosi të kthehej menjëherë në Bosnjë.

GJURMËT TË ÇOJNË NË BALLKAN

Dino Mehiç në fakt quhet ndryshe. Por ai ishte i gatshëm të fliste për Deutsche Welle-n vetëm nëse nuk do t'i tregohej emri i vërtetë. Sikurse edhe shumë të tjerë që kanë pasur fatin e tij, ai ndjehet i nëpërkëmbur, meqë është bërë pre e rrenave të rëndomta. Por nga ana tjetër, secili prej punëtorëve ilegalë kanë shkelur ligjet gjermane duke rrezikuar që, nëse kapet, t'u ndalohej hyrja në hapësirën Schengen. Veç kësaj, ata kanë frikë nga ndërmjetësi e tyre, të cilët thuhet se janë të organizuar dhe të rrezikshëm. Që kjo frikë nuk është pa baza, këtë e dëshmoi edhe rezultati i një kontrolli të befasishtëm që u bë para disa ditësh në landin Nordrhein Vestfalen. Si pasojë u arrestuan tetë persona që bënë fatura të rreme për qindra firma ndërtimi në Gjermani. Firmat ua dërgonin paratë me bankë, ndërsa ata ua kthenin sërish në dorë, duke mbajtur një komision deri në dhjetë përqind. Me paratë e mara në dorë ata paguanin punëtorët ilegalë. Evazioni fiskal i shkaktuar në këtë

mënyrë kap shumë prej se paku 35 milionë euro. Ndër të arrestuarit janë edhe tre serbë dhe një boshnjak. Hetuesit konfiskuan edhe armë, ndër të tjera dy armë automatike antitank, para dhe disa automjete.

Gjurmët e krimit të organizuar të çojnë në Ballkanin Perëndimor. Policia tatimore gjermane, që është përgjegjëse për punën ilegale, nuk parapëlqen të japë statistika. Por sipas një raporti në "Welt am Sonntag" (Gusht 2017), ku citohej një raport konfidencial i Doganës, vetëm në gjysmën e parë të 2017-ës ishin hapur 65.755 procese gjyqësore kundër punës ilegale. Shifrat reale mendohet të jenë shumë më të larta. Sipas raportit, në Gjermani punohet kryesisht në ndërtim dhe në gastronomi në të zeze. Ndër dhjetë vendet, prej të cilëve vijnë punëtorë ilegalë në Gjermani, janë edhe aspirantët për anëtarësim në BE: Serbia, Bosnja-Hercegovina, Maqedonia, Kosova dhe Shqipëria.

KËRCËNIM ME PADI

Darko Sekulic (26) nga Valjevo e Serbisë mund të flasë shumë për këtë temë. Nëpërmjet firmës slovene "Sluger", ai ka punuar si bojaxhi në Austri dhe Gjermani - pa letra. "Katër shtretër në një kontejner, aty duhej të flinim. Na je-

pnin 50 euro në javë për të ngrënë - por ato nuk na dilnin. Nuk kisha kontratë pune. Ne kishim nënshkruar diçka, por askush nuk e dinte se çfarë ishte". Kur Darkoja e publikoi në Facebook përvojën e tij, atij iu lajmëruan shumë bashkëvuajtës që ishin mashtruar në të njëjtën mënyrë nga firma e tij. Mashtruesit e kërcënuan me dhunë, raporton Darko, dhe prandaj ai e denoncoi rastin te policia serbe dhe slovene. "Unë do të këmbëngul në zbardhjen e çështjes. Ka dëshmitarë që dinë gjithçka", i premtonte ai DW.

Dosja e tij është edhe në tryezën e Goran Zrniçit. Presidenti i shoqatës "Delavska svetovalnica", një organizatë slovene, që merret me të drejtat e punëmarrësve, thotë, se naiviteti i punëmarrësve të dëshpëruar nga vendet e varfra të Ballkanit është jashtëzakonisht i madh. "Ka nga ata që janë mashtruar disa herë dhe kërkojnë ndihmën tonë. Këta punëtorë duhet ta kuptojnë se është në interes të tyre dhe të familjeve të tyre që të informohen më

mirë", thotë Zrniç për DW. Megjithë përpjekjet e përsëritura, kompania "Sluger" nuk ishte e gatshme të jepte një prononcim për DW. Në të kundërt, agjencia ndërmjetësuese "Fortuna Personal", e cila nga shumë punëtorë, duke përfshirë këtu edhe Dino Mehiçin, përshkruhet si "apar

Mbrojtësi i të drejtave të punëtorëve, Goran Zrniç, thotë se as vendet e Ballkanit e as Gjermania nuk luftojnë sa duhet kundër këtyre "tutorëve", kështu i quan ai mashtruesit dhe ndërmjetësit e punës ilegale. "Të parët duan të eksportojnë njerëzit e tyre, të tjerët duan vetëm t'i shfrytëzojnë. Ky është kapitalizëm i egër i gërshtuar me politikën"

mashtues", thotë se është me mijëra punëdhënës në kontakt dhe se mjafton jetëshkrimi dhe të dhënat personale dhe vendi i punës jashtë është thujse i sigurt.

"Fortuna Personal" organizon transportin, ofron kurse gjuhe dhe merret me dokumentet e nevojshme", shkruan Sanja Kovaç, e cila i bën reklamë firmës në rrjetet sociale dhe vetë prezantohet sikur jeton në Berlin. Por ajo vetë përshkruhet prej shumë punëtorëve si mashtruese. "Janë thashetheme të përhapura nga konkurrenca", i thotë ajo DW. "Ju para-

lajmëroj se do t'ju padisim, nëse do ta përmendni emrin e firmës tonë në ndonjë kontekst negativ", na shkroi Kovaç.


"KAPITALIZMI I EGËR"

Firma ofron një platformë kontakti edhe për punëmarrës nga Serbia, megjithëse ajo nuk bën pjesë në listën e kompanive të licensuara për punësim në Gjermani. Në listën e verifikuar edhe nga ministria e punës e Serbisë janë 105 agjenci ndërmjetësimi. "Shumë shpesh qytetarët e gjejnë vetë vendin e punës jashtë, pa ndërmjetësim. Atëherë rreziku është i madh që të jenë të pambrojtur", i përgjigjet ministria pyetjes së DW. Policia tatimore gjermane merret me luftimin e punës ilegale, por punëtorët e mashtruar dhe të papaguar mbeten në mëshirë të fatit. "Nëse ndonjërit nuk i jepet rroga, ai duhet të hedhë në gjyq punëdhënësin. Ne nuk mund të bëjmë asgjë", thotë Klaus Salzsieder nga policia tatimore. Edhe në qoftë se punëmarrësi dëbohet nga Gjermania, sepse nuk ka letra, ai prapë ka të drejtë ta hedhë në gjyq punëdhënësin e tij. Mbrojtësi i të drejtave të punëtorëve, Zrniç, thotë se as vendet e Ballkanit e as Gjermania nuk luftojnë sa duhet kundër këtyre "tutorëve", kështu i quan ai mashtruesit dhe ndërmjetësit e punës ilegale.

"Të parët duan të eksportojnë njerëzit e tyre, të tjerët duan vetëm t'i shfrytëzojnë. Ky është kapitalizëm i egër i gërshtuar me politikën". Serbi Darko Sekulic dëshiron të kthehet prapë në Gjermani. Ai tani punon si larës makinash në Serbi. Me rrogën që merr nuk arrin ta ushqejë të gjithë familjen. Përpjekja e tij e dytë në Gjermani do të jetë legale, premtonte Darko. "Unë tani po shkoj në një kurs gjuhe dhe pastaj do të aplikoj. Gruaja ime dhe unë jemi kopshtarë. Kemi dëgjuar se për këtë punë ka kërkesë në Gjermani. (DW)



KOMUNA E GOSTIVARIT
ОПШТИНА ГОСТИВАР
GOSTIVAR BELEDIYESI



www.gostivari.gov.mk
info@gostivari.gov.mk
tel. +389 (0) 42 213 511
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 18-1516/8-17
01.02.2018 vit
Gostivar

Lënda: **Njoftim për pjesëmarrje në Prezantim publik dhe Anketë publike**

Të nderuar,

Në vijim është procedura për pranim te Projektit Arkitektoniko-Urbanistik (PAU) **për formimin e parcelës ndërtuese në PKnr.5886/2; 5886/3; 5886/4 dhe PKnr.5889/5 për ndërtim të objektit me dedikim E2-pompë karburanti në KK Gostivar-2-Komuna e Gostivarit**


Në lidhje me këtë , e në pajtim me nenin 35 paragrafin (3) nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz.zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), Ju ftojme që të merrni pjesë në prezantimin dhe anketën publike që do të mbahet në hapësirat e komunës së Gostivarit më **dt.08.02.2018 (e enjte) në ora 13.00.** , njëherit Ju njoftojme se anketa publike do të zgjasë prej **09.02.2018 vit deri 12.02.2018 vit.** çdo ditë pune prej **orës 08.00-16.00** dhe gjatë asaj periudhe mundet ti dorëzoni propozimet ose vërejtjet e Juaja , në formë elektronike nëpërmjet sistemit e – urbanizëm ose në formë të shkruar në Qendrën për Shërbime Publike të Komunës së Gostivarit

Gjithashtu Ju njoftojme se në pajtim me nenin 35, paragrafi (9) nga Ligji i potencuar, nëse nuk dorëzoni propozimet ose vërejtjet e Juaja , në kohëzgjatjen e anketës publike, Komisioni për realizim të prezantimit dhe anketës publike do të llogaris se zgjidhja e planifikuar është pranuar nga ana Juaj gjegjësisht se nuk keni vërejtje për të njëjtën.

Përpiloi:Kadrije Aliu,ida
Lejoi :Sefedin Bilalli ,ida

Kryetari i Komunës
Arben Taravari

KOMUNA E GOSTIVARIT
ОПШТИНА ГОСТИВАР
GOSTIVAR BELEDIYESI



www.gostivari.gov.mk
info@gostivari.gov.mk
tel. +389 (0) 42 213 511
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 18-1755/6-17
31.01.2018 vit
Gostivar

Lënda: **Njoftim për pjesëmarrje në Prezantim publik dhe Anketë publike**

Të nderuar,

Në vijim është procedura për pranim te Projektit Arkitektoniko-Urbanistik (PAU) **për parcelën ndërtuese PN B.16.1 me dedikim D3-sport dhe rekreacion në PKnr.5882/2 KK Gostivar-2--Komuna e Gostivarit**


Në lidhje me këtë , e në pajtim me nenin 35 paragrafin (3) nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz.zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), Ju ftojme që të merrni pjesë në prezantimin dhe anketën publike që do të mbahet në hapësirat e komunës së Gostivarit më **dt.07.02.2018 (e mërkurë) në ora 13.00.** , njëherit Ju njoftojme se anketa publike do të zgjasë prej **08.02.2018 vit deri 15.02.2018 vit.** çdo ditë pune prej **orës 08.00-16.00** dhe gjatë asaj periudhe mundet ti dorëzoni propozimet ose vërejtjet e Juaja , në formë elektronike nëpërmjet sistemit e – urbanizëm ose në formë të shkruar në Qendrën për Shërbime Publike të Komunës së Gostivarit

Gjithashtu Ju njoftojme se në pajtim me nenin 35, paragrafi (9) nga Ligji i potencuar, nëse nuk dorëzoni propozimet ose vërejtjet e Juaja , në kohëzgjatjen e anketës publike, Komisioni për realizim të prezantimit dhe anketës publike do të llogaris se zgjidhja e planifikuar është pranuar nga ana Juaj gjegjësisht se nuk keni vërejtje për të njëjtën.

Përpiloi:Kadrije Aliu,ida
Lejoi :Sefedin Bilalli ,ida

Kryetari i Komunës
Arben Taravari

KOMUNA E GOSTIVARIT
ОПШТИНА ГОСТИВАР
GOSTIVAR BELEDIYESI



www.gostivari.gov.mk
info@gostivari.gov.mk
tel. +389 (0) 42 213 511
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 18-1619/6-17
31.01.2018 vit
Gostivar

Lënda: **Njoftim për pjesëmarrje në Prezantim publik dhe Anketën publike**

Të nderuar,

Në vijim është procedura për miratim të Projektit Arkitektoniko-Urbanistik (PAU) **për formimin e parcelës ndërtuese në PK nr. 2203 KK Çegran me dedikim B1 - Komuna e Gostivarit.**

Në lidhje me këtë dhe në pajtim me nenin 35 paragrafi (3) të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz.zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), Ju ftojme që të merrni pjesë në Prezantimin dhe anketën publike që do të mbahet në mjediset e Komunës së Gostivarit më datë **12.02.2018 (e hënë) në ora 13:00,** njëherit Ju njoftojme se Anketa publike do të zgjasë prej **13.02.2018 vit deri 19.02.2018 vit.** çdo ditë pune prej **orës 08.00-16.00** dhe gjatë asaj periudhe mundet ti dorëzoni propozimet ose vërejtjet e Juaja , në formë elektronike nëpërmjet sistemit e – urbanizëm ose në formë të shkruar në Qendrën për Shërbime Publike të Komunës së Gostivarit

Gjithashtu Ju njoftojme se në pajtim me nenin 35, paragrafi (9) nga Ligji i potencuar, nëse nuk dorëzoni propozimet ose vërejtjet e Juaja , në kohëzgjatjen e anketës publike, Komisioni për realizim të prezantimit dhe anketës publike do të llogaris se zgjidhja e planifikuar është pranuar nga ana Juaj gjegjësisht se nuk keni vërejtje për të njëjtën.

Përpiloi:Kadrije Aliu,ida
Lejoi :Sefedin Bilalli ,ida

Kryetari i Komunës
Arben Taravari

МАКЕДОНСКИ ШУМИ
во партнерство со природата
www.mkdsumi.com.mk

№ "Pero Nakov" E: 128, 1000 Cateje, P. Manastir
Tel. ++389 (0)2 2581080. Fax. ++389 (0)2 2581824

Në bazë të nenit 23, nga Ligji për ndërmarrje publike, (Gazeta Zyrtare e RM nr. 38/96, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15 dhe 39/16) dhe Vendimit të Këshillit drejtues për shpallje të konkursit publiknr. 02-118/4 të datës 02.02.2018, NP "Makedonski Shumi" Shkup, publikon

KONKURS PUBLIK
Për zgjedhjen e drejtorit të NP "Makedonski shumi" – Shkup

Drejtori zgjedhjet për mandat prej 4 vjet.

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme në pajtim me ligjin si dhe kushtet e posaçme të parapara me aktet e NP "Makedonski shumi" – Shkup edhe atë:

1. Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
2. Të ketë të fituara më së paku 240 kredi sipas SETK apo shkallën VII/1 të kryer të arsimimit, inxhinier i diplomuar i pylltarisë, jurist i diplomuar, ekonomist i diplomuar.
3. Në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
4. Të ketë minimum pesë vjet përvojë pune;
5. Të posedon një prej certifikatave të pranuaru ndërkombëtarisht ose certifikata për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet: TOEFL iBT së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) – të dhënë, BULATS – së paku 60 pikë ose APTIS – së paku niveli B2 me më së paku 60 pikë
6. Ka të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet;
7. Të posedojë aftësi menaxhuese.

Afati për paraqitjen e kandidatëve është **5 (pesë)** ditë pune nga dita e publikimit të konkursit në gazetata ditore.

Krahas fletëparaqitjes kandidatët duhet të dorëzojnë:

1. Biografi të shkurtë (CV)
2. Dëshmi për plotësimin e kushteve të theksuara edhe atë:
 - Certifikatë të shtetësisë
 - Diplomë ose certifikatë për përgatitjen sipërore profesionale;
 - Vërtetim nga organi kompetent se nuk i është shqiptuar masë sigurimi - ndalesë për realizim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
 - Vërtetim për përvojën e punës me përgatitjen e kërkuar profesionale;
 - Vërtetim për plotësimin e kushteve për njohjen e gjuhës angleze
 - Vërtetim që ka të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet
 - Plan dhe program për punën e ndërmarrjes publike gjatë 4 (katër) viteve të ardhshme.

Dëshmitë dorëzohen në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.
Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin dorëzohet në zarf të vulosur në adresën NP "Makedonski shumi" rr. Pero Nakov" 128 (MZT Pajisjet) – Shkup me shenjë **"konkurs për drejtor – deri tek Këshilli drejtues"** përmes postës ose në arkivin e NP "Makedonski shumi" – Shkup, çdo ditë pune prej ora 7.30 – 15.30.

“Sfidat e menjëhershme mbesin plotësimi i të gjitha kushteve për liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës dhe transformimi i shpejtë dhe i suksesshëm i FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës”, tha Thaçi

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, iu është drejtuar kabinetit qeveritar me një fjalim për nder të 10-Vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, që do të kremtohet më 17 shkurt 2018. Presidenti Thaçi në fjalën e tij ka thënë se është momenti i duhur që Bashkimi Evropian (BE) duhet të konfirmojë se e tërë Evropa Juglindore i përket BE-së e jo ideologjive tjera, që sipas tij cenojnë vlerat dhe parimet perëndimore. Ai tha se nënshkrimi i MSA-së me BE-në ka qenë mirënjohje për reformat e bëra në Kosovë në të gjithë sektorët, por edhe udhërrëfyes për rrugën integruese të Kosovës në BE.

“Brenda kësaj periudhe kemi ndërtuar marrëdhënie të shkëlqyera me shtetet e rajonit. Dialogu për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe Marrëveshja e Brukselës

PLOTËSIMI I KUSHTEVE PËR VIZAT, SFIDË PËR KOSOVËN



selit e vitit 2013 ka dhënë rezultate pozitive, edhe pse ka mbetur për t'u bërë edhe shumë”, tha Thaçi. Duke theksuar se Kosova ka plotësuar kriteret për liberalizim të vizave me BE-në, presidenti Thaçi tha se përpjekjet e fundit janë të mirëpritura për plotësimin e kriterit të fundit i cili është gjetja e një rrugëdaljeje për ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi. “Sfidat e menjëhershme mbesin

plotësimi i të gjitha kushteve për liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës, transformimi i shpejtë dhe i suksesshëm i FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës, luftimi i radikalizmit dhe ekstremizmit si dhe ruajtja e partneritetit me bashkësinë ndërkombëtare, lufta kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe të gjitha fenomeneve të tjera negative”, theksoi presidenti i Kosovës. Presidenti Thaçi gjatë fjalimit të tij poashtu

pati edhe tri propozime, ku kërkoi edhe përkrahjen e kabinetit qeveritar të Kosovës, që përfshijnë ndërtimin e një kompleksi rezidencial të institucioneve të Kosovës, ndërtimin e Muzeut të Pavarësisë që do t'i shërbejë kujtesës kolektive historike ku do të ruhen dhe ekspozohen faktet materiale të vuajtjeve dhe përpjekjeve për liri, si dhe ndërtimin e një Obeliskut të Lirisë në Prishtinë.

CNN hyn në tregun e medias shqiptare

Kanali televiziv CNN futet në tregun shqiptar mediatik me kanalin A2, përmes investitorit shqiptar ‘Gener2’, një ndër kompanitë më të mëdha shqiptare të ndërtimit dhe të infrastrukturës. Lajmin e kanë bërë të ditur vetë Gener2 në një njoftim zyrtar, ku flitet për hapjen e stacionit të parë informativ A2, me një partneritet ekskluziv me CNN, liderin botëror të informacionit. Stacioni i ri do të ketë selinë dhe qendrën kryesore të prodhimit në Tiranë, i mbështetur nga njësi informative të vendosura në qytete të tjera në Shqipëri dhe në rajon. Ngritja e A2 është rezultat i bashkëpunimit të dy emrave të rëndësishme, Gener2 dhe CNN. Të dy liderë në sektorë përkatës, Gener2 e CNN do të sjellin së bashku ekspertizën lokale dhe atë botërore, standardet dhe kapacitetet për nisjen e stacionit të ri. Stacioni televiziv, që pritet të nisë punën në fund të vitit, do të ofrojë mbulim për rezidentët në Shqipëri, si dhe miliona shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë vendit.

Kanceri në Kosovë, mbi 1500 raste për një vit

Në Kosovë gjatë vitit 2017, janë evidentuar mbi 1500 raste të reja me kancer. Mbi 170 mijë shërbime dhe 31 mijë konsulta ka kryer stafi mjekësor në Klinikën Onkologjike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Këto të dhëna i ka bërë publike për Radion Evropa e Lirë, drejtori i Institutit Onkologjik, Ekrem Hyseni, me rastin e ditës botërore e sëmundjes së kancerit, e cila shënohet më 4 shkurt.

“Numri prej 1539 rasteve të reja me kancer nuk është rritje reale e të prekurve me këtë sëmundje, por më shumë ka qenë vetëdijesimi i njerëzve për sëmundjen dhe parqitja apo vizita tek mjeku. Kanë qenë 170 mijë shërbime dhe 31 mijë konsulta, ku 24 mijë kanë marrë mjekim venoz. Lista e pritjes nuk ka qenë e gjatë, varësisht nga shërbimet, ka zgjatur nga 3 deri në 4 javë”, tha Hyseni. Klinika e Onkologjisë nga dita e premte ka filluar me aplikimin e shërbimit 24 orësh për pacientët kurativ. Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili ka premtuar se Instituti Onkologjik do të ketë furnizim më të mirë me barna dhe material shpenzues, si dhe do të rritet stafi mjekësor në këtë klinikë.

Vrasja e Ivanoviqit, gazetari serb zbulon detaje

Gazetari serb, Stefan Cvetković, gjatë një konference për media të organizuar nga Shoqata e Gazetarëve në Serbi me temën ‘Cila është kostoja e likuidimit në veri të Kosovës’ bëri të ditura disa detaje lidhur me vrasjen e liderit të iniciativës serbe në Kosovë ‘Liri, demokraci, drejtësi’, Oliver Ivanoviq. Cvetković ka pretenduar se e di se kush e ka vrarë Iva-



noviqin. Ai me këtë rast ka parqitur tri fotografi, sipas tij, të të

dysuarit për vrasjen, të një polici të veshur në uniformën e Policisë së Kosovës dhe të një personi të tretë duke biseduar në telefon në vendin e ngjarjes. Teksa për këta dy të fundit thotë se mund të jenë të lidhur me vrasjen e Ivanoviqit, të ndodhur mëngjesin e 16 janarit. Sipas gazetarit në fjalë ka deklaruar se janë dhënë 40 mijë euro për vra-

sjen e Ivanoviqit. Madje gazetari Cvetković ka thënë se gjatë hulumtimit të tyre kishin siguruar qasje edhe në kamerat e qytetarëve privat në këtë zonë. Policia e Kosovës në veri të Mitrovicës është e informuar lidhur me gjitha potencimet e gazetarit serb por që deri më tani nuk është arrestuar ende askush për vrasjen e Ivanoviqit.

Pavlopulos u mban leksione Tiranës e Shkupit!

Presidenti i republikës greke, Prokopis Pavlopulos, ka përsëritur qëndrimet tashmë të njohura për marrëdhëniet me Shqipërinë, por kësaj here ka përfshirë në deklaratat e veta edhe çështjen çame.

Pavlopulos ka deklaruar se “është e pakuptimtë që udhëheqja e Shqipërisë të shtrojë çështjen e Çamërisë”, dhe ka shtuar që “nëse Shqipëria dëshiron të ketë perspektivë europiane, më mirë të mos kujtojë se çfarë konsiston historia e të ashtuquajturve çamë gjatë mizorisë naziste në Greqi”.

Pavlopulos i ka bërë këto deklarata gjatë një ligjërate para oficerëve të shtabit të aviacionit dhe të armatës së parë, në Larisa. Duke



vazhduar me Shqipërinë, Presidenti grek ka përsëritur gjithashtu se nga vendi fqinj nevojitet zba-

timi dhe respekti i të drejtës ndërkombëtare dhe asaj europiane “dhe kryesisht respekt të të

drejtave të njeriut, qoftë kjo e drejta mbi pronën, qoftë të drejtat e minoriteteve”. Po ashtu respektim të së drejtës ndërkombëtare dhe europiane ka kërkuar Pavlopulos edhe nga Maqedonia fqinje. Për çështjen e emrit, Presidenti grek ka theksuar që “emri duhet të përjashtojë çdo lloj irredentizmi, por edhe të bëhen gjithë ndryshimet e domosdoshme në Kushtetutë, si dhe të jepen garanci që përjashtojnë irredentizmin dhe ndryshimin e kufijve”. Të njëjtën ditë me zhvillimin e manifestimit të protestës kundër përdorimit të emrit Maqedoni, Presidenti grek ka deklaruar se “çështjet kombëtare të Greqisë janë edhe çështje të familjes së gjerë europiane”.

GJERMANËT PO ARMATOSEN

Gjermanët ndjehen të pasigurt dhe po armatosen apo po stërviten në sporte marcialle dhe kurse për vetëmbrojtje

Gjermanët po armatosen. Gjithnjë e më shumë qytetarë gjermanë po bëjnë të ashtuquajturën "licencë të vogël armësh" që i lejon të mbajnë me vete armë me fishkë me gaz lotsjellës. Por edhe armë të tilla janë të rrezikshme, sepse nëse shkrepja bëhet nga një distancë e afërt, ajo mund ketë efekt vdekjeprurës. Veçanërisht dy vitet e fundit numri i gjermanëve që kanë marrë këtë licencë, është rritur jashtëzakonisht shumë. Në janar 2016, një licencë të tillë e kishin rreth 301,000 vetë - në dhjetor 2017 numri i tyre shkonte në më shumë se 557,000. Sipas shitësve të armëve për armë dhe fishkë me gaz lotsjellës, apo elektroskokë ka pasur aq shumë kërkesa sa rezervat nuk janë më të mjaftueshme. Edhe kurset për sporte marcialle apo për vetëmbrojtje, si taekwondo, po përjetojnë një bum. Sipas një ankete të institutit Infratest Dimap të janarit 2017 rreth 32 për qind e gjermanëve ndjehen të pasigurt, kurse rreth 51 për qind e tyre, ndjehen më tepër të sigurt se të pasigurt. Po



ashtu anketimi tregoi se një e katërta e të anketuarve i mënjanojnë natën sheshe apo rrugë të caktara, sepse kanë frikë. Po ashtu rreth dy të tretat thanë se mbajnë me vete për vetëmbrojtje spray me gaz lotsjellës apo armë. Shtimi i personave që janë të interesuar të blejnë armë frikësuese përkon me periudhën që Gjermania hapi kufijtë për emigrantët dhe refugjatët. Edhe anketa e institutit infratest dimap tregon se rreth një e treta e të anketuarve u shpreh se më tepër frikë kanë prej "të huajve dhe refugjatëve", pasuar prej "neonazistëve dhe të djathtëve", rreth 13 për

qind. Sociologia Dirke Hummelshheim-Doß thotë se frika lidhet kryesisht me mënyrën e prezantimit të emigracionit në media, por nëse një gjë e tillë është vërtet e argumentuar apo jo, ky është një problem tjetër. Kriminologu Arthur Kreuzer thotë se mbajtja e armëve nuk u garanton mbajtësve të tyre më tepër siguri. Po ashtu mbajtja e armëve nga persona privatë helmon klimën e bashkëjetesës. "Përhapja e mentalitetit të armëve, bëjnë që të rriten mosbesimi dhe frika, të pakësohet besimi në sigurinë publike dhe të dëmtohet monopoli i pushtetit". - thotë Kreu-

zer. Për këtë arsye, sipas sociologes Hummelshheim-Doß, një nga gjërat që ka rëndësi është që të mbajmë parasysh arsyet për ndjenjën e pasigurisë tek gjermanët. Shpesh ato nuk lidhen me vetë kriminalitetin. "Ne e dimë se frika nga krimi është gjithmonë shumë e lidhur me frikën prej ndryshimeve dhe krimi shërben si një fushë projektimi për probleme sociale. Për këtë arsye politika duhet t'i kushtojë vëmendje si ndjekjes së krimeve, por në të njëjtën kohë edhe të jetë më fort e përkushtuar ndaj shqetësimeve sociale të popullsisë".



Në janar rreth 60 fëmijë u vranë në Siri

Sipas OKB-së, konfliktet në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut kanë shkaktuar vdekjen e dhjetëra fëmijëve dhe luftimet në Siri kanë lënë 59 fëmijë të vdekur vetëm në muajin janar. Drejtori rajonal për Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut i OKB-së për Fondin e Fëmijëve (UNICEF), Geert Cappelaere, përmes një deklarate me shkrim tha se në muajin janar konfliktet dhe dhuna në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut kanë shkaktuar vdekjen e një numri të madh fëmijësh. "Ata u vranë në konfliktet që vazhdojnë, sulme vetëvrasëse ose të ngrirë deri në vdekje, përdorimi i iknin nga grupe luftarake aktive", tha Cappelaere. Ai tha se vetëm në janar, përkallëzimi i dhunës në Irak, Libi, Palestinë, Siri dhe Jemen ka marrë jetën e të paktëve 83 fëmijëve. Derisa një fëmijë u vra në një shtëpi të bllokuar në qytetin e vjetër të Mosulit në Irak, një djalë u qëllua për vdekje në një fshat afër Ramallahut në Palestinë. Në deklaratën e Cappelaeret theksohet se në mes të një stuhie të ashpër dimri në Liban, 16 refugjatë, duke përfshirë katër fëmijë, ngrinë nga i ftohti derisa po iknin nga lufta në Sirinë fqinje. "Jo qindrave, jo mijërave, por milionave fëmijë në rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikën Veriore u është vjedhur fëmijëria e tyre, të sakatuar për jetën, traumatizuar, arrestuar dhe ndaluar, të shfrytëzuar, penguar të shkojnë në shkollë dhe të marrin shërbimet shëndetësore më thelbësore", theksohet në deklaratën e Cappelaeret.

Erdogan-Papa Françesku, në fokus Jerusalemi dhe çështjet rajonale

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan dhe Papa Françesku gjatë takimit të tyre në Vatikan biseduan mbi rëndësinë që administratës amerikane t'i bëhet me dije për vendimin e gabuar të saj mbi Jerusalemin. I shoqëruar nga një delegacion zyrtarësh të lartë shtetërorë në vizitë zyrtare në Vatikan, presidenti i Turqisë Erdogan të hënën në Pallatin Apostolik në Vatikan zhvilloi takim kokë më kokë me liderin shpirtëror të katolikëve, Papa Françeskun. Sipas bu-



rimeve presidenciale, në takimin i cili thuhet se ka kaluar në një atmosferë maksimalisht miqësore, Erdogan dhe papa kanë këmbyer

mendime në lidhje me Jerusalemin, refugjatët, zhvillimet në Lindjen e Mesme me në krye Sirinë, terrorizmin dhe marrëdhë-

niet mes pjesëtarëve të feve të ndryshme. Në takim, presidenti i Turqisë dhe papa kanë theksuar nevojën për ruajtjen e statusit të Kudsit, ashtu siç përcaktohet në rezolutat e OKB-së dhe të drejtën ndërkombëtare. Erdogan ka falënderuar papën për mesazhet e tij në lidhje me Jerusalemin, ndërkohë që edhe papa ka shprehur vlerësimet pozitive për përpjekjet e presidentit Erdogan në lidhje me Jerusalemin dhe ndihmat e dedikuara për refugjatët.

DHJETËRA SHKOLLA PALESTINEZE NËN KËRCËNIMIN E RRËNIMIT NGA IZRAELI

Valent theksoi se "rënimi u krye për shkak të mungesës së lejeve të lëshuara nga Izraeli të cilat pothuajse janë të pamundura për t'u marrë"



Zyra e Kombeve të Bashkuara për Koordinimin e Çështjeve Humanitare (OCHA) tha se të paktën 45 shkolla në Palestinë po përballen me kërcënimin e rrënimit nga autoritetet izraelite. Në një deklaratë, koordinatori i OCHA-së për territoret e okupuara palestineze, Roberto Valent, vuri në dukje se

një shkollë palestineze në Kuds Lindor u shkatërrua nga ushtarët izraelitë dhe theksoi se "rrënimi u krye për shkak të mungesës së lejeve të lëshuara nga Izraeli të cilat pothuajse janë të pamundura për t'u marrë". "Ashtu si në Abu Nuwar, qindra fëmijë që janë pje-

së e të paktën një nga 45 shkollat në Bregun Perëndimor (37 në Zonën C dhe 8 në Kuds Lindor), pas urdhrorit për shembje janë duke jetuar me spektrin gjithnjë të pranishëm të rrënimit të shkollave, duke kërcënuar qasjen e tyre në edukim", tha Valent. Sipas dek-

laratës, ushtarët izraelitë shkatërruan dy klasa që shërbenim për 26 fëmijë palestinezë në komunitetin beduin dhe të refugjatëve të Abu Nuwar-it, që ndodhen në Zonën C në periferi të Kudsit. Edukimi i fëmijëve në shkollë u financua nga Bashkimi Evropian, që theksoi se shkatërrimi ndodhi pa leje. "Abu Nuwar është një nga komunitetet më të prekshme që kanë nevojë për ndihmë humanitare në Bregun Perëndimor të okupuar. Kushtet me të cilat përballen, poashtu përfaqësojnë ato të shumë komuniteteve palestineze, ku një kombinim i politikave dhe praktikave izraelite, duke përfshirë rrënimin dhe aksesin e kufizuar për shërbimet themelore të tilla si arsimit, kanë krijuar

mjedis shtrëngues që shkel të drejtat e njeriut të banorëve. Që nga shkurti i vitit 2016, ky është rrënimi i gjashtë në Abu Nuwar nga autoritetet izraelite", tha Valent. Marrëveshja e vitit 1995 midis Izraelit dhe Palestinës ka ndarë Bregun Perëndimor në zonat A, B dhe C. Autoriteti administrativ dhe i sigurisë i zonës A iu dha Palestinës, ndërsa administrata e zonës B iu dha Palestinës dhe siguria Izraelit. Në zonën C, administrata dhe siguria së bashku iu dhanë Izraelit. Komuniteti 700 banorësh beduin i Abu Nuwar-it, të cilët janë në zonën C, refuzuan të largohen nga fshatrat e tyre, pavarësisht kërcënimeve të vazhdueshme dhe presioneve nga autoritetet izraelite.



Nga prof.dr.Asllan HAMITI

Gjuhëtari ynë ka përfaqësuar arritjet shkencore në fushë të shqipësisë në Maqedoni, duke marrë pjesë aktive në shumë tubime, seminare, simpoziume e konferenca shkencore të organizuara në vend dhe jashtë tij. Kështu, në Kongresin e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, ishte delegat dhe anëtar i komisionit organizues; bashkëkryetar i Konferencës Shkencore për shënimin e 20-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, që u mbajt në Tetovë, në qershor të vitit 1992; anëtar i Këshillit Ndërkademi për Gjuhën Shqipe (themeluar në 27 tetor 2004 në Tiranë në mbledhjen e përbashkët të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës) etj.

Nga karakteri ishte i sinqertë, bujar, besnik, zemërgjerë, human, arsimdashës, largpamës, patriot. Me një vetëdije të lartë kombëtare, i shtyrë nga dëshira e flaktë për arsimimin e shqiptarëve, për disa vite rresht ligjëroi në Universitetin (siç e quanin jolegal) të Tetovës edhe përkaj rreziqeve e pasojave që mund të kishte asokohe.

Veprimtaria e prof. Remziut është e pasur dhe e shumëllojshme: lektor-redaktor i një numri të madh (afër 30) veprash të ndryshme letrare, shkencore, kulturore si dhe i shumë teksteve shkollorë të botuara në Maqedoni e Kosovë. Pothuajse katër dekada ligjëroi gjuhën shqipe në arsimin e lartë. Për nevojat e shkollimit fillor dhe të mesëm në Maqedoni hartoi disa gramatika. Veprimtaria profesionale e profesor Remziut pasqyrohet edhe në mbi 100 artikuj, studime, shqipërime (mbi 20) e monografi me vlerë shkencore.

Për ndihmesën e vyer në gjuhësinë shqiptare, prof. Remzi Nesimi u dekorua me dy medalje të arta: (1) në Akademinë solemne kushtuar 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, mbajtur më 16 e 17 nëntor 2012 në Universitetin "Fan S. Noli" të Korçës, e organizuar nga Universiteti i Korçës "Fan S. Noli", Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (Tiranë) dhe (2) tjetra në Akademinë solemne kushtuar 104 vjetorit të Kongresit të Alfabetit të gjuhës shqipe, organizuar nga shtëpia e kulturës "Koço Racin" mbajtur më 21 nëntor 2012 në Shkup.

Jo rastësisht prof. Remzi Nesimi moto të referatit të lexuar në Kongresin e drejtshkrimit, me titull "Procesi i njësimimit të shqipes letrare në Maqedoni" kishte vënë

REMZI NESIMI, KY GARDIAN I PASTËRTISË SË SHQIPES

Më se gjysmë shekulli, përkatësisht që nga vitet e 60-ta të shekullit të kaluar me përkushtim e vetëmohim, prof. Remzi Nesimi ka punuar për ngritjen e përgjithshme arsimore e kulturore dhe të vetëdijes kombëtare të popullit shqiptar në Maqedoni e më gjerë, për të lëvruar, kodifikuar dhe përpunuar shqipen standarde. Me një fjalë, me veprimtarinë e shumanshme, profesor Remziu ka dhënë ndihmesë të madhe për të ngritur gjithnjë e më lart piramidën e përbashkët kombëtare.

thënien e prof. Aleksandër Xhuvanit: "Njësia e gjuhës është njësia e kombit".

Të folmet shqipe në Maqedoni të profesor Remziu kanë zgjuar interes të posaçëm që nga rinia e tij. Punimi i magistraturës "Veçoritë fonetike të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës" (Beograd, 1971, dorëshkrim) dhe disertacioni i doktoratës "E folmja e Dervenit" (Prishtinë, 1988) janë studime të mirëfillta dialektologjike. Niveli i lartë shkencor dëshmohej edhe me studimet e botuara "Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës", "Kategoria e numrit të emrave në të folmen e Dervenit", "Diftongimi i zanoreve të theksuara i dhe u në të folmen e Dervenit" etj.

Në një periudhë trevjeçare (gjatë viteve 1995–1997) për vjeljen e pasurisë së gjuhës së popullit, prof. Remziu, në bashkëpunim me disa anëtarë të Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Shkupit (H. Ymeri, Z. Osmani, A. Poloska, A. Hamiti) dhe Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë të Tiranës (B. Beci, Ç. Bidollari), udhëhoqi një projekt kërkimor-shkencor dhe mbledhi material dialektor në pika të ndryshme të të folmeve shqipe në Maqedoni.

Zelli dhe përkushtimi i madh i prof. Remziut në kërkimet dialektologjike u kurorëzua me botimin e monografisë së mirëfilltë "E folmja e Dervenit" botuar më vitin 2008 nga Universiteti Shtetëror i Tetovës.

Vepra "E folmja e Dervenit"



Vepra "E folmja e Dervenit" është një monografi e gjerë përshkruese gjithëpërfshirëse me afër 500 faqe tekst kushtuar një të folmeje të pastudiuar, madje pak ose aspak të njohur më parë në kërkimet dialektologjike. Kjo monografi shteruese plotëson një mungesë të ndjeshme të studimeve dialektologjike për të folmet shqipe në Maqedoni.

është një monografi e gjerë përshkruese gjithëpërfshirëse me afër 500 faqe tekst kushtuar një të folmeje të pastudiuar, madje pak ose aspak të njohur më parë në kërkimet dialektologjike. Kjo monografi shteruese plotëson një mungesë të ndjeshme të studimeve dialektologjike për të folmet shqipe në Maqedoni.

Në këtë studim përshkruhet në hollësi e folmja e Dervenit në të gjitha sistemet gjuhësore: në fonetikë e fonologji, në morfologji, fjalëformim, sintaksë, frazeologji dhe leksik, duke hartuar edhe një

fjalor dialektor. Në fund janë dhënë tekste autentike, një përmblyllje dhe literatura e konsultuar me mbi 240 njësi bibliografike.

Punimi fillon me një hyrje ku përcaktohet qartë objekti i studimit e më pas përmenden studiuesit që drejtpërdrejt apo tërthorazi kanë bërë fjalë për të folmet shqipe në Maqedoni. "Toponimi Derven, - thotë autori -, sikurse edhe toponimet e tjera, si Derventa - qytet i vogël në Bosnjë, Derven - fshat në Fushë Krujë të Shqipërisë etj., është formuar nga emri i përgjithshëm, përkatësisht nga kompozita Der-bent < der "derë" + bent "lidh", që në persishte do të thotë ngushticë apo vendkalim në vende malore. Me këtë kuptim përdoret edhe në gjuhët e tjera ballkanike: në greqishte, bullgarishte, serbishte e maqedonishte. Fjala Derven, në serbishte e maqedonishte e ka kuptimin edhe fortesë e postërojë në grykë apo në vendkalim malor."

Materialin dialektor profesori e voli me vrojtim të drejtpërdrejt në të gjitha pikat e rajonit. Krahas pyetësorëve që ekzistojnë, për dukuritë specifike, sidomos në fushë të fonetikës siç është diftongimi i zanoreve /i/ dhe /u/ të theksuara, qiellzorizimi i /g/-së, grupeve pl, bl, fl; afrikatizimi i /gj/-së dhe i /q/-së etj. dhe për disa çështje të morfologjisë, si për formimin e shumës tek emrat, për fjalëformimin etj. autori ka përgatitur pyetësorë të veçantë. Në pikat e eksploruara është mbledhur

edhe material folklorik si dhe toponimet e vendbanimeve, të cilat janë shfrytëzuar si lëndë gjuhësore.

Sipas tipareve gjuhësore, - me të drejtë konstaton autori -, e folmja e Dervenit i përket të folmeve lindore të gegërishtes qendrore. Këtë të folme, si edhe pjesën më të madhe të të folmeve të arealit të gegërishtes qendrore, e karakterizojnë disa veçori fonetike e morfologjike që e dallojnë nga të gjitha të folmet e tjera shqipe.

Me punën e frytshme arsimore, shkencore e kulturore ka dhënë ndihmesë shumë të çmuar për përvetësimin e normës letrare në shkollat shqipe, në mediet e shkruara dhe elektronike në Maqedoni dhe përgjithësisht për kultivimin, pasurimin, ruajtjen e pastërtisë së shqipes nga elementet e huaja, në veçanti nga elementet sllave. Çështja e pastërtisë së gjuhës dhe zbatimi praktik i normës letrare përbën boshtin kryesor të gjithë veprimtarisë kërkimore në fushë të shqipes.

Dy vjet para mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit, përkatësisht që më 1970 në faqet e gazetës "Flaka e Vëllazërimit" që botohej në Shkup, në shtatë numra të njëpasnjëshëm paraqet dhe arsyeton rëndësinë dhe nevojën e konstitimit të një gjuhe të përbashkët letrare dhe standardizimin e saj.

Profesor Nesimin e falënderojmë dhe e përgëzojmë për kontributin që ka dhënë me veprimtarinë e pasur arsimore, shkencore e kulturore.

STADIUMI I VËLLAZËRIMIT SHNDËRROHET NË "LIQEN"

Duke pasur parasysh se ka mbetur edhe më pak se një muaj deri në startin e stinorit pranveror, varësisht prej kushteve klimatike gjatë këtij muaji që ndodhemi, ndoshta do të jemi të obliguar që ndeshjet të zhvillojmë në stadiumin e qytetit, që do të jetë një hendikep", shprehen nga Zyra për Marrëdhënie me publik e KF Vëllazërimit

Shkup, 5 shkurt - Shiu i dendur, i cili kaploi vendin tonë ditëve të fundit, ka shkaktuar përmbajtje të mëdha në disa qytete, duke përfshirë këtu edhe atë të Kërçovës. Më i prekur nga kjo situatë është stadiumi i KF Vëllazërimit, ku nga pamjet që publikuan të japin imazhin e një liqeni, ndërsa qartë vërehen dëme të mëdha materiale, që sipas krerëve të skuadrës kërçovare, kapin vlerën e 2 milionë denarëve. "Na është

shkaktuar dëm i madh, i cili shkon edhe deri në dy milion denarë. Do mundohemi diç të bëjmë me forcat tona, por patjetër se do na nevojitet edhe ndihma e institucioneve shtetërore, siç është Komuna e Kërçovës, por njëkohësisht edhe Federata e Futbollit të Maqedonisë. Duke pasur parasysh se ka mbetur edhe më pak se një muaj deri në startin e stinorit pranveror, varësisht prej kushteve klimatike gjatë

këtij muaji që ndodhemi, ndoshta do të jemi të obliguar që ndeshjet të zhvillojmë në stadiumin e qytetit, që do të jetë një hendikep, duke pasur parasysh se këtë vit pretendimet tona janë inkuadrimit në Ligën e Parë të futbollit të Maqedonisë", – shprehen nga Zyra për Marrëdhënie me publik e KF Vëllazërimit. Situata e re është goditje e madhe për mbarëvajtjen e fazës përgatitore, pasi që ditët në vijim



seancat stërvitore do të duhet ti zhvillojnë në terrene alternative. Besohet se skuadra kërçovare përgatitjet t'i vazhdojë në qytetin e Ohrit, ndërsa të martën planifikojnë ndeshjen e radhës kundër serbëve të Javorit.



De Biazzi mund të marr drejtimin e SPAL

Ish-trajneri i Kombëtares, Xhani De Biazzi është duke kërkuar një aventurë në Serinë A, pas dështimit në La Liga me skuadrën e Alavesht. 61-vjeçari është pranë akordit me SPAL-in dhe fati i tij varet nga kuqezinjët e Milanit. Skuadra e Gatosos do të ndeshet këtë javë me SPAL-in dhe në rast triumfi, skuadra që lufton për mbijetesë do të shkarkojë trajnerin aktual Leonardo Semplici për ti hapur rrugën De Biazit. "Sky Sport" raporton se ish-trajneri i Shqipërisë është emri i parë në listën e skuadrës italiane. SPAL gjendet vetëm 3 pikë larg zonës së ftohtë dhe humbja e djeshme ndaj Kaljarit i ka alarmuar drejtuesit. De Biazzi pritet të rikthehet në Serinë A mbas 8 vitesh, pasi kujtojme që herën e fundit ka drejtuar Udinezin në vitin 2010.

Javë e mirë për Berishën dhe Asanin

Shkup, 5 shkurt - Jasir Asani ka qenë autor i dy golave për skuadrën e Partizanit e cila në javën e 18 të Superligës së Shqipërisë me 2-1 ka mundur skuadrën e Kamzës. Pas këtyre dy golave dhe fitores, për "Supersport", Asani është shprehur shumë i lumtur për fitoren e ekipit, duke u shprehur se tani Evropa është shumë e arritshme. "Kisha shumë kohë që prisja të shënoja këto gola, por rëndësi ka vetëm fitorja. Tashmë kjo fitore do të na ndihmojë që të arrijmë objektivin e Evropës. Sa i përket merkatos së Partizanit, mendoj se afrimet janë cilësore. Të gjithë e dimë se çfarë përfaqëson fanella e Partizanit. Të gjithë futbollistët e dinin shumë mirë se çfarë duhet të bënin në këtë ndeshje, pas humbjeve kundër Flamurtarit. Tani kemi futbollist cilësorë në të gjitha pozicionet dhe kush stërvitet më shumë do të luajë nga minuta e parë. Mendoj se Partizani tashmë e meriton Evropën", deklaroi Asani. Ndërkohë, golin e parë për Vllazninë e ka shënuar edhe Sedat Berisha. Në përballjen ndaj kampionit aktual të Shqipërisë, Skënderbeu, Berisha shënoi për 1-0, por në fund skuadra e tij pësoi me rezultatin e thellë 1-4.



Shkupi kthehet nga Antalia

Shkup, 5 shkurt - Skuadra e F.C. Shkupit është kthyer mbrëmë nga Antalia, ku gjatë 15-të ditëve zhvilloi fazën e dytë të përgatitjeve, për sezonin pranveror, i cili fillon me 14-të shkurt, ndërsa bardhekaltërit ndeshjen e parë do ta zhvillojnë kundër Akademija Pandev në stadiumin në Çair. Nga klubi shprehen të kënaqur me përgatitjet që i zhvilluan në Antalia, sidomos janë shumë të kënaqur që asnjë nga futbollistët nuk kishin lëndime të rënda dhe kështu në këtë mënyrë i gjithë ekipi do të jetë i gatshëm për sfidën e parë të gjysmë sezonit pranveror. Ndryshe, gjatë qëndrimit 15-të ditor në Antalia, Shkupi zhvilloi pesë ndeshje kontrolluese, Karabagun (0-0), FC Stal (0-0), NK Çeilk (humb 2-0), Çornomorets Odessa (1-1) dhe së fundmi me FC Okzhetpes (fitore me 2-1). Ndërkohë, pas kthimit nga Antalia, futbollistët do të kenë dy ditë të lira, ndërsa me seanca stërvitore do të vazhdojnë të enjten. (B.K.)



Fitorja për mua dhe tifozët ishte shumë e rëndësishme

Haxhi Krasniqi iu rikthye furishëm ringut, duke e regjistruar fitoren e radhës në boksion profesionist. Boksieri kosovar e mposhti të shtunën mbrëmë boksierin polak Bartlomiej Grafkas pas vendimit të referëve. Për junikasin kjo ishte fitorja e 47-të në karrierë krahas pesë humbjeve. Ai e kontrolloi meçin dhe në fund fitoi me meritë, duke e vazhduar rrugëtimin drejt ëndrrës së tij, të shpallet kampion bote në peshat super të mesme. Me këtë rast junikasi e festoi rikthimin në ring pas 10 muajsh me fitore, ndërkohë që theksoi se ky sukses është rezultat i punës së madhe që e ka bërë. "Ja ku jam sërish! Fitorja e bindshme e ditës së shtunë për



mua dhe tifozët e mi ishte shumë e rëndësishme, prandaj po kthehem i lumtur në shtëpi. Më shumë se 5 muaj punë i kam pas vetes tani dhe kjo nuk do të ishte e mundur pa ekipin tim të mrekullueshëm. I falënderoj të gjithë nga zemra", ka thënë Krasniqi. Në javët e ardhshme me siguri që boksieri kosovar do të zbulojë më shumë rreth meçit të radhës. Ai nuk e ka ndërmend të ndalet pasi synon të vazhdojë të punojë dhe të jetë i gatshëm në çdo kohë, është i vendosur që në tentimin e tretë të shpallet kampion bote, pasi dështoi në dy tentimet e para. Krasniqi është boksieri më i mirë shqiptar në botë i viteve të fundit.

Unë jam duke u përpjekur të jap gjithçka, bashkë me stafin tim dhe lojtarët. Po bëjmë maksimumin për këtë klub. Nëse klubi e kupton këtë dhe dëshiron të zgjasë marrëveshjen, mund të flasim. Kontrata ime skadon më 2019. Dëshira dhe vullneti im janë që të vazhdoj të punoj me këtë klub”, thotë Konte

Trajneri i Çellsit, Antonio Konte, i ka kërkuar klubit që të mohojë publikisht spekulimet e vazhdueshme për të ardhmen e tij, me shumë njerëz në shtyp, që e lidhin atë me largim në fund të sezonit. Italiani, gjithashtu, këmbënguli që Çellsit duhet të mësojë të jetë më i durueshëm me trajnerin e vet, ndërsa përpjeket të konkurrojë me Mançester Sitin, me shumë më pak investime. Trajneri i “Blues” e kishte deklaruar tashmë dëshirën e tij për të qëndruar në klub për 18 muajt e mbetur në kontratë dhe shtoi se është i hapur për një rinovim. Megjithatë, ai tha se bisedimet do të jenë në pritje deri në fund të sezonit. “Duhet të jem i sinqertë, kur ka thashetheme, apo

KONTE KËRKON “VOTËBESIM” NGA ÇELLSI



spekulime pas ndeshjes së parë të sezonit, kundër Barnli, ndoshta do të doja që klubi të përgatiste një deklaratë për mua, të thoshte se beson në punën time”, – u tha Konte gazetarëve në “Cobham Training Ground”. “Por, në të njëjtën kohë, e di që kjo nuk ka ndodhur kurrë në të kaluarën, kështu që pse duhet të shpresoj për diçka të ndryshme. Sigurisht, do të doja të kisha një dek-

laratë mbështetëse të klubit kundër këtij spekulimi. Në të kaluarën, kjo nuk ndodhi kurrë. Pra, është një sfidë e madhe për të ndryshuar qasjen tani, por, sigurisht, do të isha i kënaqur, vetëm një person mund të flasë. Nuk e di, nuk duan të jenë oportunistë, të pyesin për një marrëveshje të re. Nuk është e drejtë, nuk është koha e duhur për t’u bërë oportuniste.

Kemi kohë për të marrë vendimin më të mirë. Unë jam duke u përpjekur të jap gjithçka, bashkë me stafin tim dhe lojtarët. Po bëjmë maksimumin për këtë klub. Nëse klubi e kupton këtë dhe dëshiron të zgjasë marrëveshjen, mund të flasim. Kontrata ime skadon më 2019. Dëshira dhe vullneti im janë që të vazhdoj të punoj me këtë klub”, deklaroi Konte.

Liverpuli pas mesfushorit Uilsher

Liverpuli raportohet të jetë interresuar për shërbimet e Xhek Uilsher në verë nëse mesfushori do të refuzojë rinovimin me Arsenalin. Topçinjtë i kanë ofruar një kontratë me rrogë 100,000 euro në javë. 26-vjeçari aktualisht është duke negociuar kontratën e re pasi klubi i ka ofruar disa kushte në varësi të paraqitjes së tij, për shkak të dëmtimeve të shpeshta të lojtarit. Nëse ai refuzon ofertën dhe zgjedh të mos zgjasë qëndrimin e tij në “Emirates”, Uilsher do të jetë në gjendje të shkojë në një klub tjetër si lojtar i lirë në verë. Sipas “The Sun”, trajneri i Liverpulit Jurgen Klopp është gati të paguajë rrogën e kërkuar të lojtarit për ta bindur në “Anfield”. Klopp besohet të jetë një admirues i mesfushorit dhe e sheh si zëvendësuesin e përsosur të Emre Khan që nuk ka rinovuar akoma me klubin. Gjermani ka tërhequr vëmendjen e shumë klubeve evropiane si Juventus dhe Mançester Siti dhe duket se do largohet nga Liverpuli në fund të sezonit.

Arbitri donte të ishte qendra e vëmendjes


Jurgen Klopp ka akuzuar arbitrin Xhohn Moss se donte qendrën e vëmendjes në barazimin dramatik të Liverpulit me Totenhemin. Mohamed Salah shënoi golin e parë të sfidës dhe Vanjama barazoi në fund të takimit, ku filloi edhe një histori më vete. Kin humbi një penallti të dyshimtë përpara se Sallah të shënonte një gol fantastik në kohën shtesë. Por arbitri Moss jep një tjetër penallti për Spars në sekondat e fundit të ndeshjes pas faullit të Van Dijk ndaj Lamelas. Këtë herë Kin nuk shpërdoron duke shënuar golin e



100-të në Premier Ligë. Klopp ishte i zhgënjyer dhe konfuz nga vendimet e arbitrit, që janë vërtetuar

tashmë se kanë qenë të drejtë, tha se Moss donte të merrte qendrën e vëmendjes. “Nuk e keni marrë

vesh? Nuk mund t’i afrohem dhomës së tyre deri gjysmë ore pas ndeshjes”, shprehet Klopp për “Sky Sports” kur pyetet nëse i kishite ardhur një ndjesë nga zyrtarët. “Ishte një pozicion jashtë loje i qartë në penalltinë e parë, e pabesueshme, nuk e di se çfarë po diskutonin. Po, Van Dijk e preku por Lamela po kërkonte kontaktin. Ky ishte niveli i ndeshjes së sotme, por më pas një situatë në sekondat e fundit në atë mënyrë? Ai donte të ishte në qendër të vëmendjes, dhe ia doli”, deklaroi Klop.



Interi falë Militos ia “rrëmben” Atletikos talentin argjentin



Mbrëmjen e të shtunës u vu re mungesa e Piero Ausilio në vigjilje të ndeshjes që Inter luajti me Krutone. Zakonisht është pikërisht ai që flet përpara mediave, ndërsa mbrëmë ishte Alessandro Antonello, administratori i deleguar i zikaltërve. Duket se drejtori sportive i Inter ndodhet në Argjentinë për të mbyllur përfundimisht tratativën për transferimin në Milano të yllit argjentin, Lautaro Martinez, që sipas të gjitha gjasave do të bashkohet me Inter në merkaton e verës. Ishte klubi spanjoll i Atletico Madrid ai që kishte përzgjedhur fillimisht talentin e Argjentinës që luan te Rasing de Avel-

laneda, por më pas ndërhyri Inter. Ndërkohë që në Itali, Zanetti dhe Milito, që kanë meritën e tyre në këtë tratativë konsiderohen si heronj për bindjen e lojtarit, në Spanjë, ish-bomberi zikaltër konsiderohet si fajtor për prishjen e marrëveshjes me Atletico Madrid. “Situata u përmbys dhe ky fenomen ka një fajtor, Diego Milito, mes drejtuesve të Rasing që mban një marrëdhënie të mirë me ish-skuadrën e tij. Është pikërisht ai përgjegjësi për vendimin e futbollistit, sepse është një idhull për lojtarët e Rasing dhe kështu e tij ka influencuar ndjeshëm të djaloshi”, janë komentet në Spanjë.

FILADELPHIA EAGLES FITON TROFEUN E SUPER BOUL

Në futbollin amerikan feston Filadelfia Eagles. Finale ëndrrash në edicionin e 52-të të "Super Bowl" për skuadrën nga Pennsylvania me shqiponjat që mposhtën në mënyrë surprizë me rezultatin 41-33 kampionët në fuqi të Nju England Patriots të cilët ishin favoritët e mëdhenj për të triumfuar edhe në këtë sezon

Skuadra e Filadelfia Eagles ka shkruar historinë e sportit amerikan, duke fituar edicionin e 52-të të "Super Bowl" të NFL, pas triumfit në finale ndaj Nju England Patriots (skuadër e Bostonit) me rezultatin 41-33, ndeshje e luajtur në Mineapolis. Kjo është hera e parë që skuadra e Filadelfia fiton këtë trofe në finalen e tretë në histori, një rezultat disi surprizë, pasi Nju England e ka fituar këtë trofe 6 herë dhe ishte favorite. Lojtari Nik Foles fitoi trofeun "MVP" si lojtari më i mirë, duke fituar duelin me



Tom Brady, që ishte pretendent për këtë çmim. Një ndeshje që ishte një spektakël dhe emocionet ishte të mëdha deri në fund, duke argëtuar spektatorët. Ky sukses është një nga më të rëndësishmit në historinë e sportit amerikan dhe të NFL-së. Në "Al Bank Stadium" të Mineapolis u zhvillua një nga ndeshjet më të bukura të historisë së këtij sporti, me Tom Brady që disa herë rikuperoi rezultatin dhe mbajti në lojë Nju England. Madje



Patriots dolën edhe në avantazh 33-32 për një moment, por pa mundur të fitojnë. Një "touchdown" i Nik Foles nxori sërish në avantazh ekipin e Filadelfia, me Eagles që përfituan edhe nga një

gabim i Brady në fund dhe Graham realizoi një "fumble". Këtu ndeshja përfundoi dhe Filadelfia feston suksesin e parë në NFL, në eventin sportiv më të rëndësishëm të sportit amerikan.

Nejmar në ankth

Edhe 9 ditë na ndajnë nga super ndeshja Paris Sen-Zhermen-Real Madrid, një sfidë që do të jetë e vlefshme për 1/8-at e "Champions League" dhe që ka futur në ankth yllin e PSZH, Nejmar. Brazili, në fakt, po e pret me padurim këtë takim. Përballja me kampionët në fuqi të Evropës do të jetë një provë e vërtetë për gjigantët e Francës. Një provë që do të tregojë nëse "Les Parisiennes" kanë atë që duhet për të fituar Ligën e kampionëve, që është edhe objektivi i pronarëve nga Katar. PSZH nuk ka frikë nga madrilet dhe, pavarësisht eksperiencave të këqija në sezonet e fundit të këtij kompeticioni, ata duken gati për sfidat e ardhshme. "Pres me padurim të luaj kundër Real Madrid", ka thënë Nejmar pas ndeshjes së kampionatit të luajtur dhe fituar kundër Lill, në të cilën ai realizoi një gol magjik me goditje dëni-mi.



Më e pakta që mund të bëj është t'i detyroj të heshtin



Pasi është vënë në shënjestër të disa koreve të tifozëve të Espanjolit për pjesën më të madhe të derbit të luajtur në kampionat kundër Espanjol, Xherard Pike ka thënë se më e pakta që mund të bënte ishte t'i detyronte ata tifozë të heshtnin. "Të thuash se klubi është nga Kornella nuk është një mungesë respekti, është vetëm e vërteta. Ata janë çrrenjosur nga Barcelona dhe kanë një president kinez. Ankohen për mua, por nuk shqetësohen për fyerjet që i bëhen familjes sime. Më e pakta që mund të bëj është t'i detyroj të heshtin", ka thënë mbrojtësi i Barcelonës. Pavarësisht se është kritikuar për

gjestin që ka bërë kundrejt tifozëve të Espanjolit pas golit, Pike ka bërë të ditur se lojtarët nuk do të heshtin dhe të pranojnë sulmet. "Lojtarët kanë përgjegjësi, por ka një limit për gjithçka", ka thënë ai. "Nëse ata që marrin vendimet nuk do të bëjnë asgjë për këtë, atëherë ne nuk do të heshtim. Klubet dhe pronarët duhet t'i denoncojnë thirrjet e caktuara", shtoi më tej Pike. Ndërkohe, kushtet në të cilat është luajtur ndeshja kanë qenë shumë të këqija. "Ishte e pamundur të luhej futboll në pjesën e dytë. Barazime ka qenë një rezultat i mirë dhe ne mbetemi të pamposhtur", ka përfunduar Pike.

Humb tre dhëmbë nga goditje brutale e Netos

Diego Godín duhej të zëvendësohej në fillim të "aktit" të dytë të ndeshjes Atletiko-Valencia, pas humbjes së tre dhëmbëve në një përplasje brutale me Neto. Mbrojtësi uruguaian u pa me gjak në gojë dhe u largua nga "Metropolitan Wanda". Huanfran u fut në vendin e tij. Ky ishte zëvendësimi i dytë i detyruar për Simeone, pasi Saviç, gjithashtu, duhej të largohej në pjesën e parë dhe Himenez mori vendin e tij. Atletico Madrid e mundi minimalisht Valencian, në sajë të golit të Angel Korrea, në minutën

e 59-të. Lojtarët e Simeones ngushtuan me dy pikë distancën nga Barcelona, për të qenë aktualisht nëntë pikë prapa liderit të La Ligas. Diego Godin pësoi një goditje të fortë në pjesën e dytë, që e detyroi atë të largohej nga fusha. Pas një eksplorimi të parë, raporti mjekësor thotë se lojtari vuan nga një traumë e fortë fytyre, që ka shkakuar edhe një thyerje "dentoalveolare", duke humbur tre dhëmbë. Uruguaianit i është dashur një "rindërtim" nga specialisti "maxillofacial".





DASHI 21. mars - 20. prill

Kjo është një ditë e shkëlqyer, ku do ju buzëqeshë fati në të gjitha drejtimet. Ndikimi i Venusit dhe Uranit do të jenë vendimtarë. Sa i takon sferës së ndjenjave, do jetë e pamundur për personat që ju dashurojnë që t'iu qëndrojnë larg. Ata që janë vetëm, do të korrin frytet e asaj që kanë mbjellë. Në punë, ndonëse nuk është një periudhë shumë premtuese.



DEMI 21. prill - 21. maj

Për të lindurit e kësaj shenje kjo ditë nuk do të jetë shumë pozitive, sidomos në mesditë dhe në mbrëmje, kur diçka ose dikush do ju prishë qetësinë. Në dashuri, do të kërkonit shtigje të reja, për të rigjallëruar ndjenjat dhe pasionin. Mirë është ta bëni diçka të tillë, por nuk ka pse të sforcoheni, nëse raporti funksionon. Ata që janë vetëm, do të kenë disa flirte, duke e kaluar ditën në mënyrë të këndshme.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Kjo është shenja më e favorizuar e ditës, e cila do të jetë efikase, si për sa i përket raporteve të miqësisë, edhe atyre sentimentale. Dita e parë e javës do të sjellë shumë pozitivitet dhe fat me vete, nën ndikimin e Hënës dhe Venusit. Kush nga të lindurit e kësaj shenje nuk ka qenë shumë i pranishëm në raport me partnerin/en, ky është momenti i duhur për të rikuperuar.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Nuk do të jetë një ditë shumë e lehtë, për shkak të ndikimeve negative të Venusit dhe Plutonit. Do të përballeni me kritika sa i takon raporteve ndërpersonale ose atyre në çift. Pasioni dhe dëshira për të dialoguar, do të jetë në rënie të ndjeshme. Në punë, do të përballeni me pasiguri dhe konfuzion, gjë që do ua vështirësojë ditën.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Dita e parë e javës do të jetë më se pozitive, sa i përket raporteve që kanë të bëjnë me dashurinë, miqësinë dhe deri tek familja. Kjo gjë do të favorizohet në sajë të ndikimit të Venusit, Diellit dhe të Merkurit. Në dashuri, sidomos ata që janë të lëkundur, do të vijë momenti për të marrë një vendim përfundimtar. Në punë, edhe gjërat më të vogla, mund të pengojnë ecurinë normale.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Kjo e hënë do të jetë më se e qetë, e cila në thelb do të jetë pozitive. Këshillohet që sa i takon dashurisë të mos e teproni, duke kërkuar me tepri nga partneri/ja. Bëni mirë të kënaqeni me aq sa ju jep, pasi në të kundërt do rrezikoni lidhjen tuaj. Në punë do të merrni rezultate të kënaqshme. Do të pranoni oferta të reja të kënaqshme, të cilat duhet ti shqyrtoni mirë.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Parashikohet një ditë e qëndrueshme dhe në ekuilibër. Në dashuri gjërat do të shkojnë më së miri, raportet në çift do të jenë të kënaqshme dhe intensive, si dhe do të arrini të sqaroni çdo keqkuptim që mund të keni patur. Edhe në punë do të jeni të ekuilibruar, por bëni mirë që të jeni gjatë gjithë kohës të kthjellët, në mënyrë që rezultatet tuaja të bien në sy.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Kjo ditë nuk do të nisë aspak keq! Në dashuri, ata që janë në çift, duhet të rrinë sa më pranë partnerit/es, dhe do të shohin se lidhja e tyre do të forcohet më shumë. Bëni mirë që t'iu vini një gur sipër asaj që ka kaluar. Në sferën profesionale, para se të nisni projekte të reja, mendohuni mirë, në mënyrë që të mos rrezikoni.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Nuk do të jetë një ditë shumë e favorshme, pasi prania e Merkurit dhe Uranit, do të sjellë ngatërresa në raportet ndërpersonale, duke rezultuar mjaft negative. Në raportin në çift, këshillohet që të reflektoni dhe të bëni durim. Në këtë periudhë mund të shfaqen mundësi të mira për ata që janë vetëm, të cilët mund të bëjnë njohje të reja interesante.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Kjo është një ditë normale, madje optimiste. Vlerësoni më së miri, mundësitë që do ju ofrohen. Në dashuri, mund të keni luhajtje, për shkak të ndikimit të Hënës dhe Plutonit. Në raportin në çift, mund të keni xhelozie dhe zhgënjime, në pjesën më të madhe pa bazë, por që gjithsesi do të shkaktojnë inat dhe mërzë.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Një ditë ndër më të mirat për të lindurit e kësaj shenje, në sajë të ndikimit të Venusit dhe Diellit, ku do të favorizohet fusha e ndjenjave. Në shtëpi e partnerit/es, apo personit që doni të bëni në sy, do të shkëlqeni. Sa i takon sferës profesionale, do tu hasni në disa vështirësi, për shkak të padurimit tuaj. Këshilla për ju është që t'iu kushtoni më shumë vëmendje.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Kjo fillim javë për të lindurit e kësaj shenje, nuk do të nisë shumë mirë, ndërsa me kalimin e orëve dhe kryesisht pasdite, situata do të përmirësohet. Sa i takon dashurisë, këshillohet që të veproheni me ndërgjegje të plotë për çdo gjë. Bëni kujdes sidomos në pjesën e parë të ditës, të mos e tensiononi shumë partnerin. Në sferën profesionale, mundohuni të organizoheni më mirë.



KOHA	ITHTAR I FEMINIZMIT	MALET E AMAZONIT	LEGJENDË	QË ËSHTË NGA LEZHA, LEZHAN	VEPRIMET FILM ME AKTOREN NË FOTO "...A VDEKJE"
FILM ME AKTOREN NË FOTO					
AUTORI ITALIAN, SALGARI					PYLL AKTORI AMERIKAN, HEMFRI
UNIVERSITETI (ALMA...)					RRUZULLI I TOKËS GALIUMI
INTERNATIONAL ZONE			PËRCJELLËS ZONJASH (ME PAGESË) QYLAF DERVISHESH		
SHENJË MUZIKORE AEROPORTI I TIRANËS					SHESHI PUBLIK NË GREQINË ANTIKE LARGOHEM, SHKOJ
R					ZBARDHIA E DITËS PASTHIRRMË HABIE
LIDHËZ, SI				NDALFOLJE, NË Ç'KOHE GJERMANIA	URBAN ZONE ENERGJIA
TANTALI				KURORË MBRETERORE ME GURË TË ÇMUAR	

ZGJIDHJET: K, G, LAKU, IKAR, ZANA, ADUT, LU, M, A, KB, SERI, AKTET, FAMILJA IME, EMILIO, MAL, MATER, BOTA, IZ, ZHIGOLO, NOTË, AGORA, RINASI, AGIM, SIG, KUR, UZ, TA, DIADEME.

Sudoku

shumë i lehtë

	5			2			8	
	2	4		7	9	6	1	
1				3				7
	4							
8	7	1				9	4	2
							5	
9				5				1
	3	5	1	4		8	2	
	1			9			3	

mesatar

		4					5	
	8			6	5			7
7								8
				2	5	9	7	
				2	6		1	3
				6	7	3	8	
8								6
	1			9	2			5
				9			4	

Shumë i lehtë: 759621384, 324879615, 168435297, 543912768, 871563942, 296784153, 982356471, 635147829, 417298536. Mesatar: 964817532, 283965174, 751324698, 438259761, 572641389, 196738245, 845173926, 617492853, 329586417.



I BIRI NUK IA DOLI, BABAI BËN TATUAZH SHENJËN E TIJ NË KOKË

prej kohësh i sëmurë me kancer. Rrjeti social ka qenë ditari i tij i udhëtimit gjatë sëmundjes së fëmijës dhe tani i është drejtuar sërish pas betejës së humbur. Gabriel nuk e ka kaluar krizën e fundit që e kishte prekur, mes dhimbjeve të forta pas shtrimit në spital. Pikërisht në këtë ditë në klinikë, babai Josh, në një postim të gjatë dhe prekës në "Facebook", tregon orët e fundit të jetës së djalit të tij" momente të lumtura me blerjen e lodrës së fundit që siguron - nuk mund ta harrojë kurrë. "E kam zemrën e thyer, - lexohet në disa reshata të postimit, - nuk jam duke humbur vetëm djalin tim, por edhe mikun tim më të mirë".



I ka qëndruar pranë deri në fund, por nuk mjaftoi që të mbijetonte. Josh J-Mash Marshall, nga Lawrence, in Kansans (SHBA), ka njoftuar në "Facebook" që djali i vogël i tij, Gabriel, 9 vjeç nuk mundi të kalojë krizën e fundit dhe "ka hapur krahët". Ky baba-kuajoz arriti deri aty sa të bëjë tatuazh në kokë të njëjtën shenjë të operacionit në tru që kishte kryer i biri,



Urithi i famshëm që parashikon motin

Urithi i famshëm që parashikon motin në Amerikë, "Punxsutawney Phil," parashikoi sot edhe 6 javë të tjera dimër në Amerikën Veriore. Parashikimi i Philit vjen pasi ai doli nga strofulla e tij sot, në qytetin Panksutauni në Pensilvani dhe pa hijen e tij, që sipas gojëdhënës, është një ritual që tregonse mbeten edhe 6 javë të tjera nga dimri për këtë vit. Por saktësia e parashikimit të Philit sigurisht që është e dyshimtë, ai është vetëm një urith. 2 shkurti njihet në Shtetet e Bashkuara si Dita e Urithit, kur Phil del nga zgavra në trungun e pemës, që është shtëpia e tij. Sipas legjendës, në se urithi del nga zgavra dhe sheh hijen e tij, në se është një ditë me diell, do të ketë edhe 6 javë të tjera dimër në Amerikën e Veriut. Gjenerata të tëra urithësh nga familja e Philit e kryejnë ritualin e parashikimit të motit që nga viti 1887.

Kinezët prezantojnë konceptin e ri futuristik



Kompania e njohur kineze për vetura, Hongqi (emri i së cilës nënkupton "Flamuri i Kuq"), prezanton konceptin e saj të ri futuristik duke theksuar se nuk do të ketë asgjë për versionin serik të tij. Megjithatë, disa detaje të dizajnit të këtij koncepti do të mund të gjendeshin edhe

në modelet e ardhshme të kësaj marke, për shembull maska dhe dritat e përparme. Detajet më të hollësishme në lidhje me këtë koncept nuk ka, por fjala është për një Coupe me pjesën e përparme të gjatë, ideja e së cilës na kujton modelin Vision Mercedes-Maybach 6.

"Policia e së ardhmes", Ford prezanton projektin

Ford ka paraqitur patentën për prodhimin e një motori të ri policie, por pa shofer, pra pa polic. Motori do të kontrollojë trafikun, gjobat dhe do të jetë i pari i këtij lloji që vepron bazuar mbi inteligjencën artificiale. E prodhuar nga Charles Bombardier, motori "Driverless" së shpejti do të mund të regjistrohet në radhët e policisë rrugore. Ideja e kompanisë "Ford" u konkretizua me 18 janar me aplikimin për patentën e motorit të parë robotik në radhët e policisë rrugore. Siç përshkruhet në dokument, motori do të jetë krah ekzekutiv i një sistemi kompleks të survejimit të trafikut digjital. Shkelja do të sinjalizohet në robotin më të afërt, i cili, nëse është e nevojshme, do të fillojë ndjekjen e fajtorit, ta ndalojë atë dhe ta njoftojë për shkeljen. Roboti i drejtimit do të jetë në gjendje të ketë qasje në të gjitha bazat e të dhënave për të cilat oficerët e zbatimit të ligjit nor-



malisht kanë qasje, si dhe ndaj kontrollit të targave të makinave dhe dokumenteve. Në rast të shkeljeve të trafikut rrugor, një sensor i sofistikuar dhe sistemi i kamerave të sigurisë paralajmëron shoferin dhe,

nëse shoferi vendos të mos ndalojë dhe të zgjedhë rrugën për të ikur, roboti i timonit do të jetë në gjendje të kryejë një ose më shumë veprime kundër automjetit që po largohet.

1716 - Anglia dhe Holanda rino-vojnë aleancën.

1778 - Anglia i shpall luftë Francës.

1854 - Kompozitori R Schumann shpëton nga tentimi për vetëvrasje në Rajna.

1899 - Përfundon Lufta spanjollo-amerikane. Traktati i Paqes rati-fikohet nga ana e Senatit.

1904 - Fillon lufta ruso-japoneze.

1911 - Zjarri i madh shkatërron qendrën Stambollit, Turqi.

1941 - Trupat britanike okupojnë Bengazin në Libi.

1964 - Franca dhe Britania e Madhe nënshkruajnë marrëveshje për ndërtimin e tunelit të kanalit.



1989 - Lech Walesa fillon negociatat me qeverinë polake.

1994 - Martti Ahtisaari

zgjidhet kryetar i Finlandës.

Telefoni i parë celular ishte Motorola Dyna TAC 8000X. I shpikur në vitin 1983 nga Martin Copper, një punonjës i lartë në Sony Ericsson.

Ai mund të ruante vetëm 30 kontakte me një peshë prej rreth 1.1 kg dhe koha që mund të flisje ishte 30 minuta. Çmimi i shitjes me pakicë? Rreth 3999 dollarë.



Një gjë interesante është se gati 90 për qind e telefonave celularë në Japoni janë të papërshtueshëm nga uji. Populli i Japonisë i do aq shumë telefonat celularë sa që ata i përdorin edhe në dush.



50 EURO

Dy polic duke ecur rrugës, njeri polic shef 50 euro.

- Wow 50e! E sheh mirë e mirë e pastaj e gris...

Polici tjetër e shikon e pyet:

- Pse e grise?!

- Ishte fals!

- Nga e kuptove?

- Ke parë ndonjëherë 50 euro me dy zero ti?



Ka njerëz që jetojnë për buzëqeshjen tënde... dhe ka nga ata që do të skuqen kur të kuptojnë që nuk ia kanë dalë dot ta shuajnë atë.

(Roberto Benigni)



KALENDARI HISTORIK 6 JSHKURT



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS